


# KONCEPT PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT PËR ARSIM NË DISTANCË NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Dokumentin e përpiloi grupi punues i formuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës (vendim nr.08-4895/1 më 07.05.2020) në përbërje:

Mr. Mitko Çeshllarov, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, koordinator  
Natasha Jankovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtare  
Biljana Trajkovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtare  
Elena Ivanovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtare  
Millka Masnikosa, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtare  
Natalija Kizheska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtare  
Keti Kostovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtare  
Ajshe Ajrullai, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, anëtare  
Mr. Oliver Stanojoski, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, anëtar  
Antoanella Stojanoska, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, anëtare  
Biljana Koceva, Qendra Shtetërore e Provimeve, anëtare  
Ardijana Isahi – Palloshi, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim, anëtare  
Rozalinda Stojova, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, anëtare  
Dr. Metodija Jançevski, docent, FSHIK, anëtar  
Bore Pucoski, UNICEF, anëtar  
Ana Mickovska – Raleva, QMEQ, anëtare  
Besa Reçi, QMEQ, anëtare  
Satki Ismaili, SHFK „Kirili dhe Metodi“, Tetovë, anëtare  
Sanja Kuzmanovska, SHFK „Marko Cepenkov“, Zelenikovë, anëtare  
Emilija Kosturski, SHMKM „dr. Jovan Kallauzi“, Manastir, anëtare

Koncepti për zhvillimin e sistemit për arsim në distancë në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut u miratua më 21 korrik 2020 me vendim (nr. 08-4895/2) të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.



Ky dokument është përpiluar me mbështetje të Projektit të USAID për Integrimin Ndëretnik të të Rinjëve në Arsim, Zyrës së UNICEF-it në Maqedoninë e Veriut dhe Qendrës Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ).

Përmbajtja e shprehur në dokument ju përket autorëve dhe nuk pasqyron pozicionin e UNICEF-it. Ky Koncept u përpilua me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b>	5
<b>PJESA I: POLITIKA ARSIMORE</b>	8
1. Pikënisje	8
1.1. Dokumente strategjike vendore	8
1.2. Dokumente dhe përvoja ndërkombëtare	10
2. Rregullore ligjore	13
<b>PJESA II: TEKNOLOGJIKI ARSIMORE</b>	17
1. Pikënisje	17
1.1. Infrastrukturë ekzistuese për zhvillimin e sistemit të nxënies në distancë	17
1.2. Sisteme funksionale informatike në arsimin në RMV	17
1.3. Përvoja të deritanishme për nxënie në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm në RMV	18
1.4. Përvoja në përpilimin dhe përdorimin e përmbajtjeve digjitale	20
1.5. Resurse njerëzore	21
2. Vendosje e platformës kombëtare për arsim në distancë (PKAD)	21
2.1. Shtylla të nxënies në distancë	22
2.2. Komponentë të PKAD-së	24
2.3. Karakteristika dhe funksionalitete të PKAD-së	25
<b>PJESA III: PEDAGOGJI</b>	28
1. Organizim i mësimin në distancë	30
1.1. Udhëzime themelore për planifikimin e mësimin në distancë	30
1.2. Organizim i mësimin – përpilim i orarit të orëve për nxënie në distancë	31
1.3. Koha për zhvillimin e mësimin në distancë	31
2. Realizim i mësimin	32
2.1. Përdorim i e-përmbajtjeve	33
3. Vëzhgim dhe notim i nxënësve gjatë nxënies në distancë	34
3.1. Notim formativ gjatë mësimin në distancë	34
3.2. Informacion kthyes gjatë nxënies në distancë	36
3.3. Notim sumativ	37
3.4. Metoda dhe teknika të notimit gjatë mësimin në distancë	39
4. Bashkëpunim dhe mbështetje nga prindërit/kujdestarët gjatë realizimit të mësimin dhe nxënies në distancë	40
5. Mbështetje e mësimdhënësve për realizimin e mësimin në distancë	41
6. Përfshirje dhe kompetenca të institucioneve arsimore në nxënien në distancë	42





Arsimi në distancë (ose mësimdhënia dhe nxënia në distancë), ndonëse ka traditë relativisht të gjatë, u bë jashtëzakonisht aktual në gjysmën e parë të vitit 2020 kur, thuajse, të gjitha vendet në botë për shkak të krizës shëndetësore me virusin Kovid-19 përnjëherë kaluan në nxënie në distancë në të gjitha nivelet e arsimit.

Arsimi në distancë<sup>1</sup> ose nxënia në distancë është fushë e arsimit që fokusohet në pedagogjinë, teknologjinë dhe dizajnin e sistemeve mësimore që në mënyrë efektive sigurojnë arsimimin e nxënësve/studentëve që nuk janë fizikisht “në vend të njëjtë” gjatë procesit të përvetësimit të arsimimit të tyre. Në vend të kësaj, mësimdhënësit dhe nxënësit komunikojnë në mënyrë asinkrone (në periudhë kohore, sipas përzgjedhjes personale) me shkëmbimin e materialeve të shtypura ose elektronike/burimeve për nxënie ose përmes teknologjisë që u mundëson të komunikojnë në kohë reale (sinkrone). Arsimi në distancë i organizuar me prani fizike të kohëpaskohshme të nxënësve/studentëve në vendin e ngjarjes për çfarëdo arsye, duke përfshirë edhe për shkak të dhënies së provimeve, konsiderohet si sistem ose program hibrid ose i përzier arsimor.

Përdorimi i teknologjive elektronike dhe internetit, si formë parësore e komunikimit, është karakteristika më e evidente e arsimit bashkëkohor në distancë.

Arsimi në distancë fillimisht organizohet për t'i plotësuar nevojat e atyre që nuk mund të ndjekin arsimin e rregullt (persona të punësuar, persona të cilët jetojnë në mjedise të largëta ose persona të cilët për arsye të tjera janë të penguar që të ndjekin arsimin e rregullt), e në kohën më të re, me zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) zgjerohet edhe në plotësimin e nevojave të tjera në arsim, veçanërisht në arsimin e lartë. Si rezultat, përvojat e deritanishme me arsimin në distancë janë, kryesisht, në fushën e arsimit të lartë dhe në fushën e arsimimit të të rriturve, e shumë më pak në nivelet më të ulëta të arsimit.

Përvojat nga arsimi në distancë në gjysmën e parë të vitit 2020 në vende të ndryshme ende janë duke u sistematizuar dhe nuk janë publikuar studime relevante shkencore për efektivitetin e tij.

Në shtetin tonë deri tani thuajse nuk kishte përvoja me arsimin në distancë në sferën e arsimit të detyrueshëm. Në vitet e kaluara janë miratuar një numër relativisht i madh i dokumenteve strategjike për ngritjen e cilësisë së shkathtësive digjitale edhe te nxënësit edhe te mësimdhënësit. Janë parashikuar një numër i konsiderueshëm i masave në të cilat “ndjehet” nxënia në distancë, por në asnjë dokument nuk janë parashikuar konkretisht aktivitete dhe masa për realizimin e sistemit për nxënie në distancë në sistemin formal arsimor, gjegjësisht nuk janë zhvilluar standarde për nxënie në distancë dhe e-nxënie, e as që është vendosur platformë kombëtare për mbështetjen e tërë sistemit arsimor për arsim fillor dhe të mesëm.

Kriza që u krijua me përhapjen e virusit Kovid-19 i theksoi nevojat dhe sfidat që në kushte të tilla të sigurohet e drejta e arsimit. Të gjitha vendet në botë u përballën me një situatë në të cilën nuk ekziston mundësia për funksionim të zakonshëm të arsimit formal, ndërsa duhet të sigurohet

<sup>1</sup> Nxënia në distancë, gjithashtu, e quajtur arsim në distancë, e-nxënie dhe nxënie përmes internetit, formë e arsimit në të cilën elementet kryesore përfshijnë ndarjen fizike të mësimdhënësve dhe nxënësve gjatë mësimimit dhe përdorimin e teknologjive të ndryshme për lehtësimin e komunikimit nxënës – mësimdhënës dhe nxënës – nxënës (Encyclopedia Britannica <https://www.britannica.com/topic/distance-learning>).

vazhdimësi në arsimin për të gjithë nxënësit. Nga ana tjetër, kjo krizë, përveç pasigurisë dhe frikës që e shkaktoi, nxiti edhe kërkim të zgjidhjeve të reja për organizimin dhe realizimin e mësimin dhe nxënies. Kjo është njëherësh edhe mundësi për të kuptuarit më të mirë të aspekteve të ndryshme të mësimin dhe nxënies dhe për identifikimin e veglave dhe konteksteve të reja për mbështetjen e nxënies së të gjithë fëmijëve dhe të rinjve.

Përvojat disamujore me arsimin në distancë, si në vendin tonë ashtu edhe në vende të tjera, i theksuan në plan të parë sfidat si vijon<sup>2</sup>:

- mungesë e dokumenteve strategjike dhe normative në të cilat mund të mbështetet mësimi në distancë dhe që do të sigurojnë qasje të standardizuar në realizimin e tij;
- dituri e pamjaftueshme teorike dhe praktike pedagogjike për mësim në distancë e të gjithë të përfshirëve në procesin arsimor (mësimdhënës, bashkëpunëtorë profesional, drejtorë, këshilltarë, inspektorë);
- kompetenca të pamjaftueshme digjitale të numri më i madh i faktorëve në procesin arsimor në distancë (nxënës, mësimdhënës, prindër, bashkëpunëtorë profesional, drejtorë, këshilltarë, inspektorë);
- pajisje e keqe e TIK (mungesë ose aparate joadekuate digjitale, qasje e pamjaftueshme ose kurrfarë qasje në internet) e shkollave, mësimdhënësve dhe familjeve të nxënësve.

Për këtë arsye u imponua nevoja për përpilimin e një dokumenti strategjik që do të paraqesë kornizën e organizimit të arsimit në distancë. Ky dokument ofron drejtime për vendosjen e sistemit për nxënie në distancë në shkollat fillore dhe të mesme në shtetin tonë, nga aspekti i politikave arsimore, organizimit dhe realizimit të mësimin në distancë dhe paraqet bazë për vendosjen e platformës kombëtare për nxënie në distancë dhe zbatimin e saj në nivel kombëtar.

Koncepti përmban drejtime në tri fushat kyçe në të cilat do të zhvillohet sistemi: politikat arsimore, mbështetja teknike/teknologjia arsimore dhe pedagogjia<sup>3</sup>.

Duhet theksuar se vendosja e platformës kombëtare për arsim fillor dhe të mesëm, si bazë e sistemit të arsimit në distancë, nuk nënkupton përdorimin e platformës vetëm në kushte të krizës, fatkeqësive elementare ose gjendjes së jashtëzakonshme, por platforma kombëtare dhe të gjitha funksionalitetet e saj do të përdoren edhe në punën e përditshme të shkollave, në kombinimin e mësimdhënies së rregullt me e-përmbajtje, në ofrimin e burimeve dhe qasjeve të ndryshme të nxënies, në kontrollimin e arritjeve të nxënësve, si dhe në ndjekjen dhe vlerësimin e procesit arsimor nga institucionet kompetente arsimore me një qëllim të vetëm – të vendoset sistem fleksibil i arsimit në distancë, i lehtë për ta përdorur, i përshtatshëm për nevojat individuale, si dhe i përdorshëm për nxënie në shkollë.

---

<sup>2</sup> Ende nuk janë përgatitur/publikuar hulumtime sistematike. Konstatimet janë nxjerrë në bazë të reagimeve të mediave sociale, shprehjes së mendimit publik dhe profesional në media, shqyrtimeve në vëllim më të vogël për disa situata të caktuara.

<sup>3</sup> sipas Learning Pedagogy Reference Model, Regional Task Force, UNICEF, 2020





### 1. Pikënisje

#### 1.1. Dokumente strategjike vendore

Dokument aktual sipas të cilit zhvillohen reformat në të gjitha nivelet në arsim në shtetin tonë është Strategjia për arsim 2018 – 2025<sup>4</sup>.

Në Strategjinë, nxënia në distancë është cekur vetëm në sfidat e theksuara në arsimin e lartë ku është cekur se nuk ka mundësi të mjaftueshme për nxënie në distancë për shkak të kornizës së paplotë ligjore dhe zhvillimit të dobët të platformave onlajn për nxënie.

Nga aspekti i përdorimit të pajisjes TIK dhe platformave onlajn për nxënie, në Strategjinë është përfshirë vlerësimi si vijon: “Përkundër faktit që për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme janë siguruar kompjuterë personalë në dispozicion për të gjithë nxënësit, zbatimi i TIK në procesin arsimor nuk është mjaft efektiv. Më konkretisht, mungojnë standarde për përdorimin e TIK në procesin arsimor, ndërsa të gjithë mësimmshënësist nuk janë të trajnuar mirë. Softueri që është në dispozicion nuk është adekuat për t’i plotësuar nevojat rrjedhëse, ndërsa për realizimin e shumë përmbajtjeve TIK nuk është e domosdoshme, por përkundrazi, kompjuterët më shumë pengojnë, e okupojnë hapësirën dhe e vështirësojnë komunikimin në relacionin mësimmshënës - nxënës. Njëherësh, entet parashkollore dhe shkollat e mesme profesionale nuk janë të pajisura sa duhet me kompjuterë dhe mjete të tjera TIK. Në vend ende mungon një platformë unike elektronike për mësimmshënënie dhe nxënie, si dhe për të siguruar resurse të tjera që do të shërbenin si mbështetje didaktike për mësimmshënësist dhe nxënësist, që do t’u mundësonin mësimmshënësve t’i ndajnë përvojat e tyre dhe t’i transmetojnë inovacionet pedagogjike dhe që do të kontribuonin drejt zhvillimit të mëvetësishtëm profesional të mësimmshënësve...”

Njëri prej qëllimeve të vendosura në Strategjinë është intensifikimi i zbatimit të TIK në arsim përmes vendosjes së portalit për e-nxënie dhe sistemit për menaxhim të nxënies dhe trajnimit të vazhdueshëm të kuadrit për përdorimin e teknologjive të reja dhe veglave TIK në arsim; ndërtim të sistemit për përtëritjen e pajisjes kompjuterike dhe sigurim të kushteve për mirëmbajtjen efikase të pajisjes kompjuterike dhe rrjeteve kompjuterike.

TIK dhe arsimimi digjital janë përpunuar në shtyllën e shtatë të Strategjisë të ashtuquajturat, Prioritete të përgjithshme/të përbashkëta në sistemin arsimor. Prandaj, në njërin prej prioriteteve (prioriteti III) të përcaktuara me Planin e veprimit, që është pjesë përbërëse e Strategjisë, përfshihet Sigurimi i përdorimit të gjerë të TIK në arsim, si dhe trajnimi dhe arsimimi digjital. Si nënprioritete, mes tjerash, janë përcaktuar edhe: Përdorimi i TIK në procesin e nxënies dhe Vendosja e platformës unike elektronike për ligjërim, nxënie dhe resurse metodologjike. Për ndjekjen dhe realizimin e këtyre prioriteteve janë parashikuar disa indikatorë, siç janë:

<sup>4</sup> <http://www.mon.gov.mk/index.php/2014-07-23-14-03-24/vesti-i-nastani/2549-2018-2044>



- standarde të aprovuara për përdorimin e TIK në të gjitha nivelet e arsimit;
- pajisje të nevojshme të siguruara të TIK nga së paku 50 % të institucioneve publike arsimore;
- softuer të zhvilluar arsimor për përdorimin e TIK sipas standardeve, që u është siguruar përdoruesve;
- kuadro të trajnuara nga institucionet e pajisura për përdorimin e TIK në procesin arsimor;
- e-platformë tërësisht e kapshme operative me resurse të azhurnuara për mësimdhënie dhe nxënie të kuadrit në të gjitha nivelet arsimore.

Në Strategji janë dhënë edhe afate për implementimin e aktiviteteve<sup>5</sup>, por, duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese me krizën shëndetësore dhe nevojën për vendosje të shpejtë të sistemit për arsim në distancë, procesi i përpunimit të platformës kombëtare, si dhe pajisja e shkollave mund të zhvillohet me një ritëm të përshpejtuar dhe në përputhje me planin e ri të veprimit.

Qëllimet, prioritetet dhe aktivitetet e përmendura në Strategjinë për arsim 2018 – 2025 mund të konsiderohen pikënisje dhe kornizë për planifikimin e realizimit jo vetëm të aktiviteteve konkrete, por edhe zgjerimin dhe vendosjen e tyre në njërin prej koncepteve për nxënie në distancë për të gjitha nivelet e arsimit.

Gjithashtu, koncepti i ri i merr parasysh edhe përvojat dhe zgjidhjet dhe udhëzimet e përcaktuara, si dhe aktivitetet e zbatuara, që janë dhënë edhe në dokumente të tjera strategjike të përpiluara prej institucioneve të ndryshme në shtet, siç janë:

- Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për sajber-siguri 2018 – 2022 (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, korrik viti 2018)<sup>6</sup>.
- TIK-strategjia afatshkurtër kombëtare 2016 – 2017 (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, gusht viti 2015)<sup>7</sup>.
- Strategjia kombëtare për e-përfshirje 2011 – 2014 (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, maj viti 2011)<sup>8</sup>.
- Strategjia kombëtare për zhvillimin e e-përmbajtjeve viti 2010 – 2015 (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, korrik viti 2010)<sup>9</sup>.

Në vijim është përpilimi i standardeve kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor, ndërsa vijon edhe përpilimi i standardeve për arritjet e nxënësve në fund të arsimit të mesëm në të cilat fusha Kompetenca digjitale është përshtatur me dokumentet përkatëse të Komisionit Evropian.

Në bazë të standardeve kombëtare do të zhvillohen edhe programe të reja mësimore në përputhje me planin mësimor për arsim fillor dhe planet mësimore për arsim të mesëm. Standardet e parashikuara në fushën Kompetenca digjitale do të shërbejnë jo vetëm për zhvillimin e programeve mësimore që janë të lidhura drejtpërdrejt me fushën e informatikës, por ato do të jenë të vendosura

<sup>5</sup> Zbatimi i aktiviteteve është parashikuar në periudhën e viteve 2020 – 2025. Më konkretisht, përpilimi i platformës unifikuar elektronike për ligjërata, nxënie dhe resurse metodologjike, pilotimin e saj dhe lëshimi në përdorim është parashikuar për vitin 2022, për kur është parashikuar edhe përpilimi i e-përmbajtjeve, derisa furnizimi i pajisjes TIK dhe softuerit arsimor për përdorimin e TIK në përputhje me standardet është parashikuar për vitin 2025.

<sup>6</sup>[http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/ns\\_sajber\\_bezbednost\\_2018-2022.pdf](http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/ns_sajber_bezbednost_2018-2022.pdf)

<sup>7</sup>[http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/Kratkorocna%20IKT%20Strategjia\\_avgust2015.pdf](http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/Kratkorocna%20IKT%20Strategjia_avgust2015.pdf)

<sup>8</sup>[http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/Strategjia\\_za\\_e-vklucivanje.pdf](http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/Strategjia_za_e-vklucivanje.pdf)

<sup>9</sup>[http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/strategjia\\_e-sodrzini\\_2.pdf](http://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/strategjia_e-sodrzini_2.pdf)

në programet mësimore nga të gjitha lëndët tjera ku është i domosdoshëm zhvillimi i diturive, shkathtësive dhe qëndrimeve nga kjo fushë dhe përdorimi i teknologjisë dhe pajisjes informatike në arritjen e rezultateve më të mira të nxënësve.

Në dokumentin Kompetenca themelore profesionale për mësimdhënësit, si edhe në Kompetencat për drejtorët janë vendosur disa kompetenca të caktuara digjitale, por të njëjtat nga aspekti i arsimit në distancë nuk janë të mjaftueshme dhe duhet të plotësohen me kompetenca të reja.

## 1.2. Dokumente dhe përvoja ndërkombëtare

Rekomandimet e organizatave relevante ndërkombëtare deri tani nuk kishin të bëjnë me arsimin masiv në distancë në një të ardhme të afërt, por e promovuan digjitalizimin në arsim si hap të domosdoshëm të radhës në evoluimin e arsimit bashkëkohor. Në këtë drejtim Bashkimi Evropian ka përpiluar disa dokumente kyçe strategjike:

- **Kornizë evropiane e kompetencave digjitale të qytetarëve (DigiComp)<sup>10</sup>**, dokument që është zhvilluar në vitin 2016, ndërsa është azhurnuar në vitin 2018 dhe përfshin pesë (5) fusha kyçe me tregues konkret:
- Arsimim informatik dhe të kuptuarit e të dhënave: shfletim, kërkim dhe filtrim i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjeve digjitale; vlerësim i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjeve digjitale; menaxhim i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjeve digjitale.
- Komunikim dhe bashkëpunim: bashkëveprim me ndihmën e teknologjive digjitale; shkëmbim përmes teknologjive digjitale; përfshirje në aktivitete qytetare përmes teknologjive digjitale; sjellje etike në internet; menaxhim të identitetit digjital.
- Krijim i përmbajtjeve digjitale: zhvillim i përmbajtjeve digjitale; integrim dhe shtjellim i sërishëm i përmbajtjeve digjitale; të drejta autoriale dhe liçenca/leje; programim.
- Siguri: Mbrojtje të aparateve; mbrojtje e të dhënave personale dhe privatësisë; mbrojtje të shëndetit dhe mirëqenies; mbrojtje të mjedisit.
- Zgjidhje e problemeve: zgjidhje e problemeve teknike; identifikim i nevojave dhe zgjidhjeve teknike; përdorim kreativ i teknologjive digjitale; identifikim i jazeve në raport me kompetencat digjitale.

Korniza përcakton edhe tetë nivele të arritjeve të kompetencave digjitale: fillore (1 dhe 2), e mesme (3 dhe 4), e avancuar (5 dhe 6) dhe me specializim të lartë (7 dhe 8) dhe ofron mënyra të thjeshta për vlerësimin e zhvillimit të kompetencave.

- **Korniza evropiane e kompetencave digjitale të edukatorëve /mësimdhënësve (DigiEduComp)<sup>11</sup>**, që ka të bëjë me edukatorët në të gjitha nivelet e arsimit, ndërsa i përfshin edhe arsimin joformal, arsimimin e të rriturve dhe arsimimin e personave me nevoja të posaçme. Korniza përbëhet prej gjashtë (6) fushave me kompetenca konkrete.
- Angazhim profesional: komunikim organizativ; bashkëpunim profesional; praktikë reflektuese; zhvillim të vazhdueshëm digjital profesional.

<sup>10</sup> European Commission. *Digital Competence Framework for Citizens (DigComp 2.0)*. 2018. <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/bc52328b-294e-11e6-b616-01aa75ed71a1/language-en>

<sup>11</sup> European Commission. *Digital Competence Framework for Educators*. 2017. <https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu>

- Resurse digjitale: seleksionim; krijim dhe modifikim; menaxhim; mbrojtje dhe shkëmbim.
- Mësimdhënie dhe nxënie: mësimdhënie; udhëheqje; nxënie bashkëpunuese; nxënie e vetëudhëzuar.
- Notim: strategji për notim; analizë e dëshmime; informacion kthyes dhe planifikim.
- Mbështetje e nxënësve: qasje dhe përfshirje; diferencim dhe personalizim; angazhim aktiv i nxënësve.
- Përmirësim i kompetencave digjitale të nxënësve: arsimim informatik dhe mediatik; komunikim; krijim të përmbajtjeve; përdorim i përgjegjshëm; zgjidhje e problemeve.
- Korniza përfshin gjashtë (6) nivele të vlerësimit të kompetencave (fillestar, hulumtues, studiues, ekspert, lider dhe pionier).

Përveç kësaj, Komisioni Evropian ka zhvilluar edhe **Kornizë për organizata kompetente digjitale arsimore (DigiCompOrg)**<sup>12</sup>, e cila përbëhet prej shtatë (7) elementeve kyçe dhe pesëmbëdhjetë (15) nënfushave të përbashkëta për të gjithë sektorët arsimorë. Përmes veglës SELFI (SELFIE), Komisioni Evropian u ndihmon shkollave që t'i zhvillojnë strategjitë e tyre digjitale në mënyrë që t'i përmirësojnë nxënien dhe mësimdhënien.

Sipas raportit Evridika (2019)<sup>13</sup>, pjesa më e madhe e sistemeve arsimore evropiane i kanë përfshirë kompetencat digjitale si temë ndërlëndore dhe kanë përfshirë rezultate nga nxënia. Ndonëse të gjitha sistemet arsimore kanë një lloj të strategjisë për ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të kompetencave digjitale, zakonisht të shtetet e Evropës Lindore kjo është pjesë e ndonjë strategjie më gjithëpërfshirëse, derisa të tjerët (kryesisht nga Evropa Perëndimore, Qendrore dhe Veriore) paraqet strategji të veçantë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kompetencat digjitale sipas dokumenteve programore përvetësohen përmes lëndës së veçantë mësimore (të detyrueshme dhe zgjedhore) dhe si qëllim ndërlëndor në të gjitha nivelet e arsimit.

Lidhur me mbështetjen e shkollave, pjesa më e madhe e shteteve parashikojnë investime në infrastrukturën digjitale, ndërsa vetëm një e treta parashikojnë masa për trajnimin e drejtorisë së shkollës për promovimin e arsimit digjital. Rreth gjysma e shteteve kanë politika për mbështetjen dhe angazhimin e të ashtuquajturve koordinatorë digjitalë që ushtrojnë funksion teknik dhe pedagogjik. E ngjashme është gjendja edhe në vendin tonë. Në një periudhë të caktuar të gjitha shkollat ishin të pajisura me një numër të madh të kompjuterëve (program: Kompjuterë për secilin fëmijë), por sot numri më i madh i kompjuterëve janë ose të vjetruar ose nuk janë në përdorim. Të gjithë mësimdhënësit morën trajnim për shkathtësi themelore TIK, ndërsa drejtorët në trajnimet e tyre, gjithashtu, kanë modul për trajnim për përdorimin e TIK.

Në pjesën më të madhe të sistemeve arsimore, e edhe në vendin tonë, prej mësimdhënësve pritet që të jenë të arsimuar në aspektin digjital, ndërsa kompetencat digjitale që janë specifike për mësimdhënësit janë dalluar si pjesë e kompetencave themelore të mësimdhënësve. Ndonëse përkufizimet dhe vëllimi i shkathtësive janë të ndryshme, të gjithë bëjnë të ditur se mësimdhënësit duhet të dinë të integrojnë teknologji digjitale në mësimdhënien dhe nxënien, si dhe të dinë t'i

<sup>12</sup> <https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomporg/framework>

<sup>13</sup> European Union. *Digital Education at School in Europe*: Eurydice Report, 2019.

përdorin në mënyrë efektive. Autoritetet janë përgjegjëse për sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional në raport me arsimin digjital përmes nismave të ndryshme që fokusohen në aspekte të ndryshme të digjitalizimit të shoqërisë. Në pesë shtete janë vendosur rrjete të mësimdhënësve që i përkushtohen digjitalizimit në arsim.

Në shtetin tonë zbatimi i TIK në mësim në një periudhë ishte njëri prej prioriteteve në arsim, një pjesë e mësimdhënësve ndiqnin trajnime përkatëse, por trajnime të tilla nuk ofrohen si pjesë e përsosjes profesionale.

Në përgjithësi, notimi i kompetencave digjitale në mësimdhënies është proces i cili mundëson autonominë e mësimdhënësve dhe është i rregulluar në masë të jokonsiderueshme nga autoritetet arsimore në nivele më të larta.

Në vendin tonë bëhet notimi i diturive dhe shkathtësive të përvetësuar në kuadër të lëndëve mësimore: Punë me kompjuter dhe baza të programimit, Informatikë (në arsimin fillor dhe të mesëm), por jo edhe TIK-kompetencat e përvetësuar dhe treguara në përgjithësi.

Hulumtimi i OECD-së për arsim dhe inovacione me titull „Mësimdhënësit si disenjatorë të mjedisit për nxënie“<sup>14</sup> ofron udhëzime që mund të ndihmojnë në zhvillimin e politikave arsimore dhe avancimin e procesit edukativo-arsimor. Hulumtimi thekson se pedagogjia është kyçe në realizimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe në përkufizimin e politikave arsimore. Me fjalë të tjera, politikat arsimore i rekomandojnë dhe i mbështesin qasjet në pedagogjinë për t'i arritur qëllimet arsimore dhe rezultatet e parashikuara. Qëllimi është që nxënësit të kenë arritje, qëndrime dhe kompetenca më të larta arsimore që janë të nevojshme për jetesë në një shoqëri bashkëkohore demokratike dhe të jenë të aftësuar për nxënie të përvetshme.

Hulumtimi përqendrohet në inovacionet pedagogjike në arsim, që udhëzojnë dhe janë të rëndësishme në procesin e vendosjes së ndryshimit në mënyrën e nxënies dhe mësimdhënies. Inovacionet pedagogjike kërkojnë ndryshime rrënjësore në praktikat e mësimdhënësve dhe rolin e tyre në realizimin e mësimin. Gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor mësimdhënësit përdorin dhe kombinojnë një varg metodash, qasjesh, praktikash dhe teknikash në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet komplekse. Hulumtimi bën të ditur se për këtë nevojitet një ekspertizë e thellë dhe mirëkuptim, e jo vetëm rutinë në zbatimin e teknikave.

Në procesin e nxënies dhe mësimdhënies, varësisht nga lënda mësimore, disa qasje të caktuara pedagogjike janë më adekuate për arritjen e disa kompetencave të caktuara. Më pas, gjatë përzgjedhjes së pedagogjisë arsimore merret parasysh edhe prejardhja sociale dhe kulturore e nxënësve në mënyrë që të adresohen diversitetet në klasë.

Me vendosjen e qasjeve novatore ndikohet te mësimdhënësit dhe mënyrën e mësimdhënies. Hulumtimi thekson se as përdorimi i TIK, e as teknologjia që zbatohet vetvetiu nuk e përmirësojnë nxënien. Inovacion në pedagogji nënkupton ndryshimin e praktikave dhe roleve të mësimdhënësve. Nevojitet vendosje e bashkësive për nxënie ose rrjeteve që do ta mbështesin

---

<sup>14</sup> [https://read.oecd-ilibrary.org/education/teachers-as-designers-of-learning-environments\\_9789264085374-en#page24](https://read.oecd-ilibrary.org/education/teachers-as-designers-of-learning-environments_9789264085374-en#page24)

transformimin përmes zhvillimit të qasjeve pedagogjike, materialeve, shkëmbimit të diturive dhe liderizmit.

Në raportin e Komisionit Evropian me titull **„Digital Education Policies in Europe and Beyond“**<sup>15</sup> janë dhënë shembuj të politikave të reformës digjitale në arsim të një numër i caktuar i vendeve evropiane dhe vendosje të platformave për nxënie në distancë, që mund të japin ide dhe udhëzime gjatë vendosjes së sistemit tonë kombëtar për nxënie në distancë dhe përcaktim të performancave të platformës kombëtare për arsim fillor dhe të mesëm.

Raporti i përmendë parimet vijuese si të rëndësishme në zbatimin e politikave për arsim digjital: 1. ndjekje të qasjes holistike në vendosjen e ndryshimit sistemor; 2. vendosje të vizionit afatgjatë dhe qëllimeve të realizueshme afatshkurtra; 3. Përdorim të teknologjisë si mjet, e jo si qëllim; 4. eksperimentim, marrje përsipër të rrezikut dhe dështimit; 5. shqyrtim të rëndësisë dhe kufijve të vlerësimit të ndikimit; 6. përfshirje e të gjitha palëve të prekura në dialog të strukturuar; 7. motivim të shkollave dhe mësimeve; 8. zhvillim të kompetencës mësimore.

Deri në krizën me virusin Kovid-19 interesi ishte kryesisht i orientuar drejt përdorimit, integritetit të arsyeshëm të teknologjive digjitale në aspekte të ndryshme të procesit arsimor, me ç'rast theksi ishte vendosur në përmirësimin e infrastrukturës digjitale dhe ngritjen e kapaciteteve të mësimeve për përdorimin e saj, si për shembull: përdorim të mjedisit virtual për nxënie, të platformave dhe veglave digjitale. Në kohën e krizës me virusin Kovid-19 të gjitha vendet nga mësimi në klasë u hasën në situatë që të kalojnë në nxënie në distancë, kështu që krahas çështjeve për infrastrukturën dhe kompetencat e mësimeve, në fokus u vendosën edhe çështjet e përshtatshmërisë së qasjeve të shfrytëzuara pedagogjike për mësim në distancë dhe aspektet sociale dhe emocionale të arsimit në distancë. Në mënyrë intensive shkëmbeuherin përvoja dhe mendime për “pedagogjinë e re”, por ende nuk ka njohuri të mjaftueshme relevante të bazuara në hulumtime dhe fakte.

## 2. Rregullore ligjore

Arsimi fillor dhe i mesëm në shtetin tonë rregullohen në mënyrë sistemore me tri ligje: Ligjin për arsim fillor, Ligjin për arsim të mesëm dhe Ligjin për mësimeve dhe bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor dhe të mesëm.

Duke marrë parasysh faktin që në ligjet e përmendura nuk është parashikuar nxënie në distancë, në kohën e shpalljes së pandemisë së virusit Kovid-19 dhe masave të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut se shkollat nuk do të mbajnë mësim, u paraqit një vakuum juridik se si të rregullohet në mënyrë normative nxënia në distancë, gjegjësisht nxënia në shtëpi, për nxënësit e vitit shkollor 2019/2020. Kjo gjendje u tejkalua pjesërisht me miratimin e dekretive me fuqi të ligjit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Nevoja për zgjidhje sistemore të nxënies në distancë, jo vetëm në kushte të pandemisë ose pandemisë të re eventuale, por nxënie në distancë si sistem i ri, plotësues, alternativ ose paralel i

<sup>15</sup> Conrads, J., Rasmussen, M., Winters, N., Geniet, A., & Langer, L. *Digital Education Policies in Europe and Beyond: Key design principles for more effective policies* (No. JRC109311). Joint Research Centre (Seville site), 2017.

arsimit, kërkon që të shqyrtohen opsione të ndryshme për organizimin dhe funksionimin e tij, ndërsa zgjidhjet e ofruara të përfshihen në Ligjin për arsim fillor, Ligjin për arsim të mesëm dhe Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor dhe të mesëm.

Ndryshimet dhe plotësimet duhet të mundësojnë kornizë ligjore për vendosjen dhe realizimin e mësimi cilësor dhe nxënies në distancë.

Në Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor dhe të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19) ndryshimet duhet të jenë në drejtim të rregullimit plotësues të detyrave të punës së mësimdhënësit në kushte të nxënies në distancë, përcaktimit të mënyrës në të cilën mësimdhënësi do ta përdorë teknologjinë informatike në kushte të ndryshme të mësimi, kohës për planifikimin dhe realizimin e punës së tij gjatë javës së punës.

Është me rëndësi që të parashikohen edhe në Ligjin, e veçanërisht në aktet nënligjore që rezultojnë nga ai, kompetenca themelore profesionale të mësimdhënësit në raport me përdorimin e teknologjisë së avancuar informatike për planifikimin dhe realizimin e mësimi në kushte të nxënies në distancë.

Më tutje, nevojitet plotësim i të gjitha neneve të Ligjit dhe të akteve nënligjore që rezultojnë, e që kanë të bëjnë me zhvillimin profesional dhe në karrierë të mësimdhënësve, duke filluar nga përcaktimi i numrit të orëve për trajnime parësore për punë me teknologji informatike dhe përdorim në mësim dhe nxënie në distancë, e deri te kompetencat e nevojshme të mësimdhënësit për avancim në karrierë.

Në Ligjin për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19), si dhe në Ligjin për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/1995, nr. 24/1996, nr. 34/1996, nr. 35/1997, nr. 82/1999, nr. 29/2002, nr. 40/2003, nr. 42/2003, nr. 67/2004, nr. 55/2005, nr. 113/2005, nr. 35/2006, nr. 30/2007, nr. 49/2007, nr. 81/2008, nr. 92/2008, nr. 33/2010, nr. 116/2010, nr. 156/2010, nr. 18/2011, nr. 42/2011, nr. 51/2011, nr. 6/2012, nr. 100/2012, nr. 24/2013, nr. 41/2014, nr. 116/2014, nr. 135/2014, nr. 10/2015, nr. 98/2015, nr. 145/2015, nr. 30/2016, nr. 127/2016, nr. 67/2017 dhe nr. 64/18) nevojiten plotësime në qëllimet e arsimit, në mënyrën e organizimit dhe realizimit të mësimi, përcjelljen dhe notimin e arritjeve të nxënësve.

Nevojitet që me ligjet e përmendura të përcaktohen obligimet dhe afatet për plotësimin dhe ndërlidhjen e platformës së re kombëtare me ESARU dhe e-ditarin, të përcaktohen edhe standardet e nxënies në distancë, e veçanërisht kur dhe në çfarë kushtesh do të përdoret nxënia në distancë.

Në mënyrë që të mundësojë përdorim të përhershëm të sistemit, më së miri është që në ligjet të përcaktohet një numër i ditëve kur shkolla do të mund të realizojë mësim në distancë, gjegjësisht një numër të orëve ose temave të programeve mësimore që do të duhet doemos të realizohen me përdorimin e platformës kombëtare, e, gjithashtu, të gjithë nxënësit të cilët për arsye të ndryshme mungojnë nga mësimi një periudhë të caktuar të mund të qasen në sistemin dhe në këtë mënyrë të ndjekin mësimin ose të marrin detyra nga mësimdhënësit e tyre.

Është veçanërisht e rëndësishme që të përcaktohet mënyra e organizimit të mësimi (orar, numër i orëve), mënyra e realizimit të mësimi (kohëzgjatja e orëve, aktiviteteteve) dhe mënyra e notimit të arritjeve të nxënësve.

Duke marrë parasysh faktin se vendoset zgjidhje sistemore për nxënie në distancë përmes një platforme të caktuar, nevojitet që të gjitha aktivitetet që realizohen në shkollë, e që janë pjesë e të ashtuquajturit program të zgjeruar të shkollës ose janë pjesë e programit vjetor të shkollës, të parashikohet që të jenë pjesë e plotësimeve ligjore për nxënie në distancë.

Në këtë mënyrë, duhet të parashikohen edhe mënyrat e realizimit në distancë të aktiviteteve jashtëshkollore, mësimi shtesë dhe plotësues, garave të nxënësve.

Nga ana tjetër, përmes standardeve kombëtare për arritjet e nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe përmes programeve mësimore nga lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe përmes programeve mësimore nga lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore në arsimin fillor dhe të mesëm do të parashikohet forcim i kompetencave të nxënësve për përdorimin e TIK dhe nxënies në distancë.

Plotësimet ligjore duhet ta theksojnë sigurinë e nxënësit dhe të dhënave e tij personale gjatë nxënies në distancë.

Në raport me udhëheqjen dhe vendimmarrjen e shkollave, nevojitet që të parashihen plotësime dhe të mundësohet që këshillat e mësimdhënësve, aktiveve, këshillit drejtues dhe trupat tjerë në shkollë të mund të mbahen në distancë, me ç'rast vendimet e miratuara do të konsiderohen të vlefshme.

Gjithashtu, nevojitet të plotësohet edhe Ligji për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit për nxënës dhe universitetit të hapur civil për mësim të përhjetshëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 10/15, nr. 145/15, nr. 192/2015, nr. 30/16, nr. 120/18 dhe nr. 140/18) në raport me modulën Teori e organizimit ku do të shtohen përmbajtje për organizimin e shkollës kur mësimi realizohet përmes nxënies në distancë, gjegjësisht nxënies në shtëpi.









### 1. Pikënisje

#### 1.1. Infrastrukturë ekzistuese për zhvillimin e sistemit të nxënies në distancë

Pajisja kompjuterike në shkollat fillore dhe të mesme në nivel kombëtar është furnizuar në vitin 2009-2010. E njëjta përdoret më së shumti për mësim në lëndët nga fusha e informatikës, mirëpo, karakteristikat e saj nuk janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave për vendosjen e arsimit në distancë.

Të gjitha objektet kanë qasje në internet prej së paku 4/0.5 megabite në sekondë (Mbps) download/upload, së paku një IP-adresë statike përmes të cilës mund të ketë qasje deri te ruteri, internet-mjedis i mundësuar i sigurt dhe i besueshëm ku klientët janë të mbrojtur prej virusëve dhe sulmeve të tjera virtuale nga interneti. Të gjitha objektet (të gjitha shkollat fillore dhe të mesme) kanë qasje deri te interneti me brez të gjerë që e siguron Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), përveç shkollave fillore në mjediset rurale (ka siguruar për 63 prej gjithsej 119 objekteve).

Shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, gjegjësisht 23 shkolla të mesme janë edhe të lidhura drejtpërdrejt me IT-infrastrukturën e MASH-it të vendosur në FSHIHK, gjegjësisht krahas lidhjes standarde të internetit ka lidhje plotësuese me kapacitet të madh (1 gigabit) për nevojat e klasave në të cilat ka smart tabela dhe pajisje për telekonferencë. Katër (4) prej këtyre shkollave kanë pajisur dy klasa, prej të cilave njëra klasë është e pajisur me video-pajisje për realizimin e video-ligjëratave, ndërsa tjetra me audio-pajisje për prani të video-ligjëratave. Në shkollat tjera ka vetëm nga një klasë të pajisur për prani të video-ligjëratave.

Pajisja për sistemet që përdoren nga MASH-i është si vijon: IDC cloud data center me 20 serverë, serverë për video-konferencë dhe pajisje për magazinimin e të dhënave (të vendosura në hapësirat e FSHIHK-së).

#### 1.2. Sisteme funksionale informatike në arsimin në RMV

- **SEPASH<sup>16</sup>**. Sistemi Elektronik për Punë Administrative të Shkollave paraqet një sistem informativ për udhëheqje në arsim dhe është vegël për grumbullimin, përpunimin, kontrollin dhe prezantimin e të dhënave që janë të rëndësishme për procesin arsimor në arsimin fillor dhe të mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sistemi i mbledhë, i përpunon dhe i prezanton të dhënat për nxënësit në shkollat publike fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- **Ditari elektronik** (e-ditari) ka për qëllim të përmirësojë komunikimin mes mësimeve dhe prindërve, t'i informoj prindërit për suksesin e arritur të fëmijëve të tyre, të mundësojë shqyrtim të shpejtë dhe të thjeshtë të informacioneve nga ditari nga ana e mësimeve në shkollë, të

<sup>16</sup> ESARU

mundësojë analiza të centralizuara dhe të shpejta statistikore nga MASH-i dhe nga institucionet tjera shtetërore. Në bazën e këtij sistemi ruhen të dhëna për nxënësit, paralelet në të cilat mësojnë dhe shkollat.

### 1.3. Përvoja të deritanishme për nxënie në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm në RMV

Përvojat me arsimin në distancë në arsimin e detyrueshëm (arsim fillor dhe i mesëm) në shtetin tonë, deri në mars të vitit 2020, mund të barazohen me disa tentime të ndara dhe entuziazëm të disa mësimdhënësve dhe shkollave të caktuara për të përdorur platforma për realizimin e mësimit dhe nxënies. Kriza shëndetësore me Kovid-19 e imponoi nevojën që të gjitha shkollat në një periudhë shumë të shkurtër të kalojnë në mësim në distancë që realizohet në periudhën mars-qershor të vitit 2020<sup>17</sup>. Krahas shkollave fillore dhe të mesme, në periudhën e kaluar edhe institucionet e larta arsimore i përdornin përparësitë e sistemeve për mësim në distancë për realizimin e mësimdhënies, dhe nuk janë të rrallë shembujt ku edhe provimet mbaheshin përmes veglave për komunikim.

Nga përvojat e deritanishme mund të përmendet përdorimi i portaleve/platformave vijuese për nxënie:

- **Eduino** është portal arsimor në pronësi të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, që ofron përmbajtje digjitale si mbështetje të procesit arsimor në shtet. Pjesët kryesore të portalit janë: 1) sistem për “e-mësimdhënie”, i zhvilluar për krijimin dhe shpërndarjen e përpunimeve të përmbajtjeve mësimore në formë të video-leksioneve dhe 2) sistem për “nxënie dhe zhvillim të hershëm”, i zhvilluar për nxënie të mbështetur në lojë me qëllim që të nxisë zhvillimin socio-emocional të fëmijët. Pjesa “e-mësimdhënie” përbëhet prej tri funksionaliteteve: e-klasë/e-mësimtore për aktivitete, e-orar dhe e-teste.
- **E-klasë/e-mësimtore për aktivitete** është sistem për krijimin dhe shpërndarjen e përpunimeve të përmbajtjeve mësimore në formë të video-leksioneve dhe përfshin: a) vendosje të kriterëve teknike për përpunimin e video-koleksioneve dhe infrastrukturës për ruajtjen e tyre, b) trajnim dhe mbështetje përkatëse teknike të mësimdhënësve, c) sistem të kontrollit dhe verifikimit të materialeve që pranohen.
- **E-orari** është sistem që mundëson krijimin e orarit digjital të ligjëratave, shpërndarje të orareve me nxënësit dhe realizimin e ligjëratave përmes veglës së integruar për telekonferenca.
- **E-teste** është sistem për kontrollin e diturive dhe informacionit kthyes deri te nxënësit. Baza me pyetje për tema nga programet mësimore mund të përdoren me kombinim, por edhe me plotësim.
- **EDMODO** është platformë arsimore falas në mënyrë që të lidhen dhe të bashkëpunojnë nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Mundëson krijimin e grupeve, shkëmbimin e përmbajtjeve mësimore dhe dokumenteve, përcjelljen e punës së nxënësve ose grupeve të caktuara, komunikim me mësimdhënës, prindër dhe nxënës të tjerë, arkivim të gjithë punës së nxënësve në një vend, krijim të fletëve të punës dhe pyetësorëve, si dhe materialeve të tjera. Është mundësuar qasje e prindërve për përcjelljen e fëmijëve të tyre.

---

<sup>17</sup> Shiko më poshtë në tekstin: analizë e përdorimit të nxënies në distance në kushte të krizës shëndetësore.



- **EPISTUM** është platformë për udhëheqje të nxënies (Learning Management System - LMS) që përdoret nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për nevojat e trajnimeve për administratën dhe nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit për nevojat e trajnimeve të mësimdhënësve. E njëjta është e bazuar në MUDELL (anglisht: Modular Open Oriented Dynamic Learning Environment – MOODLE) dhe i sendërtuar në mënyrë plotësuese për të mbështetur të ashtuquajturin multi-tenancy, gjegjësisht mundëson që shkolla/institucione të ndryshme të kenë instancë personale virtuale të sistemit me mundësi që të njëjtin ta përshtatin në përputhje me nevojat personale – dizajn, ngjyra, logo dhe administratën e tyre.

EPISTUM është ueb-platformë e bazuar e dizajnuar që t'u sigurojë edukatorëve, administratorëve dhe nxënësve sistem unik, të fuqishëm dhe të integruar për krijimin e mjediseve të personalizuar për nxënie. I njëjti mundëson vendosje dhe shpërndarje të lehtë të materialeve, përfshin diskutime dhe biseda onlajn, ofron teste/kuisë, anketa dhe fjalorë, mbledhje dhe kontrollim të detyrave dhe shënim të notave. Sistemi është i planifikuar që t'i integrojë standardet ekzistuese nga fusha e e-nxënies (ARIADNE, ADL, SCORM, IMS, IEEE LTSC, AICC, DCMI) dhe të mbështesë realizimin onlajn të mësimin në kohë reale.

Modulariteti dhe transparenca e platformës mundëson përshtatjen e thjeshtë dhe të shpejtë të saj ndaj parametrave dhe integritit me sisteme dhe regjistra të tjerë për qëllimet dhe nevojat e PKAD-së. Për nevojat e nxënies në distancë, integrimi i këtij sistemi me sistemet tjera është i domosdoshëm, për shkak të marrjes së të dhënave që ata i përmbajnë. Sisteme themelore që përmbajnë të dhëna të nevojshme për këtë sistem janë: sistemi elektronik për punë administrative të shkollave (ESARU) dhe sistemi e-ditar (ednevnik.edu.mk), të cilat përmbajnë të dhëna për mësimdhënësit dhe nxënësit, shkollat, planet mësimore etj. Sistemi është i përgatitur tashmë të përdorë sistemin për paralajmërim të vetëm - SPV (Single Sign On - SSO) për mësimdhënësit nga sistemi e-ditar.

Në mënyrë që të shqyrtohen përvojat e mësimdhënësve nga realizimi i arsimit në distancë, në vijim është përgatitja e **analizës së përdorimit të nxënies në distancë në kushte të krizës shëndetësore**.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit, si përdorues kryesorë, me mbështetje të Zyrës së UNICEF-it në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe "Reaktor – hulumtim në veprim", zbatojnë hulumtim gjithëpërfshirës në shkollat fillore dhe të mesme lidhur me krizën shëndetësore që ka të bëjë me virusin Covid-19, e që në masë të madhe në periudhën mars-qershor

të vitit 2020 ndikonte në mënyrën në të cilën realizohej procesi edukativo-arsimor në vendin tonë. Qëllimi themelor i hulumtimit është që t'i përmbledhë të gjitha përvojat relevante dhe të vlerësojë ndikimin e përgjithshëm të pandemisë Kovid-19 në procesin arsimor në vend. Përmes përfshirjes së të gjitha palëve të prekura (dhënësit dhe përdoruesit e shërbimeve në sektorin arsimor): drejtorë, mësimdhënës, prindër dhe nxënës, ky hulumtim do të japë shqyrtim të drejtpërdrejt në përvojat e ndryshme dhe aspektet e rëndësishme të nxënies në distancë.

Hulumtimi zbatohet në dy faza. Faza e parë e këtij hulumtimi zbatohet në periudhën 25 qershor – 5 korrik të vitit 2020 dhe duhet të japë shqyrtim në përvojat e para personale nga procesi arsimor në periudhën nga mbyllja e shkollave, më saktësisht nga 10 marsi, deri në fund të vitit shkollor 2019 – 2020. Në fazën e dytë të hulumtimit do të bëhet përmbledhje e përvojave nga fillimi i vitit të ardhshëm shkollor.

#### 1.4. Përvoja në përpunimin dhe përdorimin e përmbajtjeve digjitale

**E-libra shkollorë.** Ky portal (<https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/>) paraqet një bibliotekë digjitale për ruajtje, kërkim dhe shfletim të librave elektronik shkollorë të dedikuar, para së gjithash, për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm, por edhe për mësimdhënësit dhe prindërit e tyre. Ideja për vendosjen e portalit është që nxënësve t'u mundësohet shkarkim falas të librave shkollorë në mënyrë që të njëjtit t'u ndihmojnë në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore në një mënyrë novatore dhe interesante, ndërsa mësimdhënësve në përgatitjen dhe prezantimin e materialit mësimor me ndihmën e teknologjive informatike. Në fillim, librat shkollorë janë botuar në formë të e-librave (e-book), ndërsa në rast se shkarkoheshin, shkarkimi kalojnë në PDF format.

Librat shkollorë janë të ndarë në grupe për arsim fillor dhe të mesëm, ndërsa arsimit mesëm është ndarë në të mesëm gjimnazi dhe të mesëm profesional. Mirëpo, këtu janë publikuar vetëm libra shkollorë që kanë leje për përdorim në shkollat fillore dhe të mesme, përveç librave shkollorë që Departamenti për furnizimin e librave shkollorë nuk është në gjendje t'i publikojë për shkak të mbrojtjes së të drejtave autoriale. Në momentin e krijimit të këtij dokumenti, në këtë portal mund të shkarkohen 282 prej gjithsej 970 librave të përmendur shkollorë.

Ndonëse idea është portali të ofrojë qasje deri te librat shkollorë, megjithatë, duhet të mendohet për përmirësimin e gjithë konceptit për libra shkollorë elektronikë, ashtu që në të ardhmen të krijohen libra shkollorë në formë të e-librit (e-book) si dhe audio-libra që veçanërisht janë të rëndësishëm për fëmijët që kanë shikim të dëmtuar, disleksion, etj. dhe të njëjtat të jenë të arritshme përmes PKAD-së, por të përfshijë edhe librave shkollorë „bashkëveprues“ edhe materiale të punës për nxënësit, në vend se vetëm të “pasqyrohen” librat e shtypur shkollor në formë elektronike, dhe kuptohet, të gjendet zgjidhje që të gjithë librat shkollorë të aprovuar nga MASH-i të jenë në dispozicion dhe të mund të shkarkohen nga portali.

**Video-leksione.** Byroja për Zhvillimin e Arsimit përmes portalit Eduino, gjatë periudhës prej muajit mars deri në qershor të vitit 2020, vendosi një sistem për krijimin dhe katalogjizimin e video-leksioneve sipas përmbajtjeve mësimore dhe verifikimin dhe kontrollin e cilësisë së tyre. Deri në fund të vitit shkollor janë vendosur 1.740 video-leksione deri te të cilat janë qasur më shumë se 300.000 përdorues. Video-leksionet janë përpunuar në pesë gjuhë mësimore (shumica prej tyre në gjuhën

mësimore maqedonase dhe shqipe) dhe përfshijnë: dy grupmosha (3-4 vjeç dhe 4-6 vjeç) dhe katër fusha të zhvillimit (gjuhë dhe të folurit, matematikë gazmore, shkencë – njoftim dhe kuptim i mjedisit, art – edukatë figurative dhe muzikore) në arsimin parashkollor; të gjitha klasat dhe lëndët në arsimin fillor dhe një pjesë e përmbajtjeve në arsimin e mesëm.

Skool.mk Portali skool përmban 512 e-përmbajtje nga lloji i simulimeve, leksione dhe shënime të shkurtra, nga fushat e shkencave natyrore dhe matematika, për arsim fillor dhe të mesëm. Të njëjtat janë përkthyer dhe lokalizuar në përputhje me programet kombëtare për arsim, dhe pritet që të përdoren dhe integrohen në PKAD.

## 1.5. Burime njerëzore

Për realizimin e papenguar të mësimdhënies kyçe janë burimet njerëzore, edhe atë jo vetëm të kuadrit mësimdhënës por edhe të kuadrit të përgjithshëm që mbështetë, ndihmon dhe siguron kushte për mësim.

Në këtë proces marrin pjesë:

- rreth 18.272 mësimdhënës të cilët janë të përfshirë në arsimin fillor,
- rreth 7.476 mësimdhënës të cilët janë të përfshirë në arsimin e mesëm,
- rreth 1.000 mësimdhënës që realizojnë mësim nga informatika dhe lëndët e ndërlidhura në arsimin fillor dhe të mesëm,
- rreth 100 administratorë të punësuar në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, të sistemuar në aspektin rajonal në gjithë shtetin, të cilët kanë për detyrë t'u japin mbështetje shkollave në funksionimin e papenguar të internetit dhe pajisjes, sendërtimin e tyre dhe ndihmë tjetër.

Rritja e shpejtë dhe inovacionet në teknologjitë informatike/të informacionit, veçanërisht në situatën e pandemisë të shkaktuar nga virusi Kovid-19, pa dyshim e lë imperativin e rritjes dhe përmirësimit të kompetencave IT të të gjithë kuadrit mësimdhënës dhe ndihmës. Kjo nevojë është e mbuluar në mënyrë të pamjaftueshme me trajnime të përhershme dhe të dedikuara, për tema të ndryshme duke përfshirë edhe testet elektronike.

## 2. Vendosi të platformës kombëtare<sup>18</sup> për arsim në distancë (PKAD)

Në botë ekzistojnë tri qasje të ndryshme globale ndaj arsimit në distancë në raport me mënyrat në të cilat mund të shfrytëzohen teknologjitë, veglat dhe procedurat në procesin e arsimit:

- **Përfshirje e teknologjisë** – teknologjitë për mësim janë vendosur në mësimin klasik tradicional. Kjo qasje do të duhej të zbatohet në mësimin e rregullt ku nxënësit dhe mësimdhënësit do të përdorin teknologji për arritjen më të lehtë të qëllimeve të nxënies.
- **Qasje e kombinuar** – pjesë të mësimin mbahen në klasë tradicionale, ndërsa një pjesë e mësimin mbahet përmes veglave të arsimit në distancë. Qasja e kombinuar mund të përdoret edhe në

---

<sup>18</sup> **Platforma për nxënie** është përmbledhje e integruar e shërbimeve bashkëvepruese të rrjeteve që u mundësojnë mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, si dhe të gjithë të tjerëve që janë të përfshirë në arsimin, qasje deri te informacionet, veglat dhe resurset për mbështetje dhe forcim të realizimit dhe menaxhimit të procesit arsimor.

mësimin e rregullt ku disa vegla dhe materiale të caktuara do të ishin të kapshme 24/7, si edhe në kushte ku prania fizike e nxënësve nuk është e detyrueshme.

- **Konvertim total** – arsimi dhe trajnimi tradicional klasik shëndrohet në një ose më shumë formate të arsimit në distancë. Konvertimi total është qasje që përdoret në situata si kjo në të cilën gjendemi kur prania fizike e nxënësve nuk është e mundshme dhe mësimi zhvillohet tërësisht onlajn.

Duke marrë parasysh qasjet e përmendura të arsimit në distancë, propozohet vendosje e sistemit për nxënie në distancë që do t'i kombinojë të gjitha qasjet e përmendura dhe i njëjti do të jetë i bazuar në vendosjen e platformës kombëtare.

Detyrat themelore të platformës kombëtare për arsim në distancë (PKAD) janë:

- mbështetje e mësimin në shkollë dhe nxënies në distancë,
- përcjellje e arritjeve të nxënësve,
- zhvillim profesional i mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkolla,
- shkëmbim i dokumenteve, përvojave dhe ideve,
- rrjetëzim i mësimitdhënësve, nxënësve, shkollave dhe institucioneve arsimore,
- informim të prindërve për aktivitetet në shkollë dhe për nxënësit.

## 2.1. Shtylla të nxënies në distancë

PKAD-ja duhet të sigurojë, zbatim të sigurt dhe të barabartë (në nivel të njëjtë dhe me karakteristika të njëjta) të procesit arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në territorin e gjithë shtetit, duke ofruar me këtë rast mundësi të barabarta dhe qasje për të gjithë pjesëmarrësit në proces, si në kushte të jashtëzakonshme, ashtu edhe në kushte normale/të rregullta.

Shtyllat kryesore të procesit të arsimit në distancë janë: infrastruktura, platforma për arsim në distancë (vendosja e së cilës në nivel kombëtar është objekt i këtij dokumenti), përmbajtjet digjitale dhe parakushtet organizative.

- **Me infrastrukturë** nënkuptohet infrastruktura e domosdoshme për funksionimin e platformës dhe infrastruktura e domosdoshme për përdoruesit e platformës.
  - **Harduer.** Infrastruktura e harduerit duhet të jetë me kapacitet të mjaftueshëm për të mbështetur punën e papenguar të platformës kombëtare për nxënie në distancë në kushte të qasjes konkurrenente deri te e njëjta nga të gjithë mësimitdhënësit dhe nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme. E njëjta varet nga karakteristikat dhe performansat e vetë platformës, por duhet të përfshijë edhe teknologji ndihmëse në rastet ku paraqitet nevoja.
  - **Qasje në Internet.** Qasja në Internet është njëri prej parakushteve themelore për funksionimin e arsimit në distancë. Për këtë qëllim nevojitet që të gjithë përdoruesit e PKAD-së (nxënës, mësimitdhënës, prindër, të punësuar në MASH, BZHA, QAPT, ISHA, QSHP, komunat) të kenë qasje në internet. Lokacioni në të cilin do të vendoset PKAD-ja duhet të ketë qasje në internet me kapacitet të mjaftueshëm për t'i shërbyer të gjithë përdoruesit e platformës.

- **Qasje deri te aparatet personale - kompjuterë.** Qasja deri te kompjuteri është njëri prej parakushteve themelore për zbatim efektiv dhe gjithëpërfshirës të arsimit në distancë. PKAD-ja dhe resurset e saj duhet të jenë të përshtatura që të jenë të ndjekura edhe në aparate celulare/ aparate-tabletë, gjegjësisht në aparatet të cilat e kanë ndonjërin nga ueb-shfletuesit ekzistues. Duhet të merret parasysh se aparat personal është i domosdoshëm për secilin nxënës, në mënyrë që të mund t'i realizojë të gjitha aktivitetet: të ndjekë mësim, të lexojë përmbajtje, të shkruajë detyrat e shtëpisë, të bëjë teste, etj.
- **Përmbajtje digjitale (e-përmbajtje)<sup>19</sup>**
  - **Zhvillimi i përmbajtjeve digjitale duhet t'i** ndjekë praktikat më të mira për zhvillimin e materialeve mësimore digjitale duke përdorur metoda novatore (si për shembull: bashkëveprim, gejmifikim, personalizim) dhe formatet e përgjithshme të pranura në përputhje me standardet ekzistuese ndërkombëtare për përmbajtje mësimore digjitale.
  - **Është e nevojshme në PKAD-së të jenë në dispozicion e-librat shkollorë të aprovuar nga MASH-i, në PDF-format dhe në format të e-librit (e-book).**
- **Parakushte organizative**
  - **Ndërlidhje me sisteme, regjistra dhe baza të tjera.**  
Sistemi për nxënie në distancë duhet domosdoshmërisht të shkëmbejë të dhëna me sisteme të jashtme, siç janë: sistemi ESARU, me të cilin do të shkëmbejë të dhëna për nxënësit, mësimdhënësit, prindërit, planet dhe programet mësimore; sistemi e-ditar, me të cilin do të shkëmbejë të dhëna për e-mail adresa të mësimdhënësve; Regjistri qendror i popullsisë, me të cilin do të shkëmbejë të dhëna themelore për personat fizikë; Sistemi i informacionit për menaxhim të resurseve njerëzore, që është regjistër i të gjithë të punësuarve në sektorin publik; sistemet ekzistues për nxënie, por edhe sisteme të tjera.
  - **Trajnime të mësimdhënësve dhe administratorëve në shkolla**  
Vendosja e çfarëdo sistemi informatik nuk sjellë rezultatet pa qenë të trajnuar përdoruesit e tij, me çka krahas diturive dhe shkathtësive për përdorimin e tyre do të përvetësojnë edhe besim, kështu që secili nga përvoja personale do të gjejë mënyrën më të mirë për pranimin e sistemit dhe integrimin e tij në obligimet e veta profesionale. Trajnimi duhet të mundësojë bazë që mësimdhënësit me sistemin, para së gjithash, të pasurojnë dhe lehtësojnë mësimdhënien, e jo ta pranojnë si barrë plotësuese.
  - **Formimi i njësisë organizative në MASH dhe BZHA kushtuar mirëmbajtjes së PKAD-së**  
Mirëmbajtja e sistemit funksional kombëtar dhe mbështetja për përdorimin e tij të papenguar nga mësimdhënësit dhe nxënësit, domosdoshmërisht nënkupton edhe ekzistimin e një ekipi të përkushtuar që do të jetë pronar i sistemit. Ekipi nga njësia do të ketë për detyrë të sigurojë implementim të sistemit në përputhje me ligjet, sigurim të funksionimit të tij të përhershëm të papenguar dhe mirëmbajtje të rregullt teknike, dhënie të propozimeve për ndryshimin e akteve relevante ligjore, zbatim të sendërtimeve të nevojshme të platformës, zbatim të analizave, përpilim të raporteve, hartimin e planeve për përdorim, etj.

<sup>19</sup> **E-përmbajtje** (përmbajtje digjitale) është përmbajtje mësimore në format digjital, që mund të përbëhet prej kategorive dhe elementeve si vijon: prezantime, prezantime bashkëvepruese, animacione, simulime, video-shënime, audio-shënime, diagrame, harta, tekste, kuizë, teste.

- **Përkufizim i prioriteteve strategjike për shkathtësi digjitale në nivel kombëtar**

Në kohën e digjitalizimit, shkathtësitë digjitale të popullatës duke përfshirë edhe grupet e ndryshme qëllimore janë me rëndësi vitale dhe fushë që është gjithnjë e më lartë në prioritetet e vendeve në suaza botërore. Përkufizimi i prioriteteve strategjike të Magedonisë për shkathtësi digjitale, në nivel kombëtar, do të jepte udhëzime të sakta për masat që duhet të ndërmerren, palët e përfshira, dinamikën dhe buxhetin e nevojshëm.

## 2.2. Komponentë të PKAD-së

Platforma kombëtare për arsim në distancë do të mund të përballet me pritjet dhe sfidat nëse i posedon së paku **komponentët si vijon** (building-blocks):

- **Menaxhim të përdoruesve.** Përdoruesit e sistemit duhet të menaxhohen varësisht nga rolet e tyre. Të dhënat për secilin përdorues duhet të jenë të ruajtura me masa të sigurisë, në përputhje me ligjet. Ato duhet të jenë në dispozicion për vetë përdoruesin dhe përdoruesit e lidhur në të (prindër, mësimdhënës). Futja e përdoruesve të ri, çaktivizimi, ndryshimi i të dhënave, roll-out, resetimi i fjalëkalimeve dhe aktivitete të tjera, detyrimisht duhet të jenë të mundësuar në platformën.
- **Menaxhim të roleve dhe permisioneve/privilegjeve.** Roli paraqet përmbledhje të permisioneve të përkufizuara në sistem që mund t'u ndahen përdoruesve të caktuar në kushte dhe kontekste specifike. Kjo, nga ana tjetër, e përkufizon aftësinë e përdoruesit për të bërë një aktivitet të caktuar në një lokacion të caktuar në sistemin. Shembuj më të shpeshtë janë rolet: nxënës, mësimdhënës, administrator, moderator, autor.
- **Menaxhim të programeve mësimore/njësive mësimore.** Në njësitë mësimore, mësimdhënësit mund të shtojnë materiale për nxënie dhe aktivitete për nxënësit e tyre, në përputhje me programet mësimore dhe planet mësimore për një lloj dhe nivel të caktuar të arsimit. Njësitë mësimore mund të jenë të krijuara prej administratorëve, autorëve të njësive mësimore ose role të tjera. Pas vendosjes ose krijimit, mësimdhënësit mund të shtojnë përmbajtje dhe t'i riorganizojnë sipas nevojave të mësimin. Njësitë mësimore duhet të kenë mundësinë të përmbajnë teste për vetë njësitë.
- **Menaxhim të nxënies.** Ndërlidhja e përdoruesve: nxënës – mësimdhënës – paralele duhet të jetë e siguruar në mënyrë që të mund të përcillet statusi i nxënies së nxënësve dhe përparimi i tyre.
- **Menaxhim të dokumenteve.** Platforma duhet t'i mundësojë mësimdhënësit që në mënyrë të lehtë t'ua prezantojë materialet mësimore nxënësve të tyre. Këto materiale mund të jenë në datoteka të formës së ndryshme, siç janë: dokumente tekstuale, prezantime, etj. Për disa forma, nxënësit duhet të posedojnë softuer përkatës për t'i hapur. Dokumentet mund të paraqiten në një faqe, si dokumente individuale, ose të organizuara në strukturë të dosjeve. Për shembull, një mësimdhënës do të shpërndajë një dokument të vetëm në PDF-format, por një mësimdhënës tjetër mund të formoj dosje me dokumente që nxënësit duhet t'i ndërmarrin për nxënie ose për përpunim.
- **Bërje të kopjeve rezerve.** Sistemi, bazat e përdoruesve dhe e-përmbajtjet për shkaqe sigurie duhet të ruhen në kopje rezerve përmes rrugës automatike, me mundësi për rregullimin e dinamikës dhe mënyrës së krijimit të kopjeve rezerve.



- **Menaxhim i të dhënave për qëllime të raporteve.** Raportet janë pjesë e rëndësishme e procesit arsimor dhe përfshijnë raporte për nxënësit dhe prindërit, raporte në nivele të ndryshme: paralele, vite, shkolla, mësimdhënës dhe kritere të tjera. Të njëjtat mund të jenë raporte të rregullta, të planifikuara dhe paracaktuara ose raporte ad hoc për nevoja të ndryshme. Mbajtja e të dhënave të azhurnuara dhe cilësore, në vend të sigurt, me qasje të shpejtë deri te të dhënat, është detyrë e këtij komponenti.
- **Mbajtjet të mësimin në kohë reale.** Platforma duhet të sigurojë mundësinë për mbajtjen e mësimin në kohë reale.
- **Ndjekje të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional.** Funksionalitetet e nevojshme për këtë komponent janë përfshirë në komponentët paraprak, por janë adaptuar për sigurimin dhe ndjekjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Ato duhet të përshtaten për ndjekje përmes sigurimit të e-përmbajtjeve dhe e-trajnimeve për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional, si dhe përkufizim të roleve dhe privilegjeve përkatëse.

### 2.3. Karakteristika dhe funksionalitete të PKAD-së

PKAD-ja duhet të ketë **karakteristikat** si vijon:

- Të mbështesë lloje të ndryshme të standardeve për e-përmbajtje: SKORM (SCORM)<sup>20</sup>, pdf, ppt\*, doc\*, xls\*, ods por edhe formate të tjera për video dhe audio shënime.
- Të jetë e lehtë dhe e thjeshtë për t'u vendosur në regjim të punës.
- Të jetë e thjeshtë dhe intuitive për përdorim.
- Të jetë fleksibile për rregullim, veçanërisht në raste të rritjes së numrit të përdoruesve dhe materialeve mësimore.
- Të jetë interoperabile, gjegjësisht të mund të shkëmbejë të dhëna dhe dokumente me sisteme të tjera (për shembull: ESARU), aplikacione/module (për shembull: video-konferenca, vebinarë) dhe regjistra (baza, për shembull: e-ditar).
- Të sigurojë sistem për paralajmërim unik në mënyrë që përdoruesit t'u qasen përmbajtjeve prej burimeve të ndryshme të aprovuara nga BZHA-ja.
- Të mundësojë menaxhim të thjeshtë me shtojca dhe module plotësuese (add-ons, plugins).
- Të mbështesë standarde të hapura.
- Të ketë mundësi për vendosjen e materialeve dhe përmbajtjeve të jashtme.
- Të zbatohen standardet për qasje deri te ueb-përmbajtjet për persona me pengesë - Udhëzime për qasje deri te ueb-përmbajtjet (UQUP) 2.0<sup>21</sup> (WCAG 2.0).

**Funksionalitete** që duhet t'i ketë platforma:


- Mbështetë shumëgjuhësi në nivel të platformës.
- Identifikim dhe vërtetim të sigurt të përdoruesve.
- Import masiv të përdoruesve, dhënie masive të detyrave/trajnimeve, etj.
- Mundëson tabelë të personalizuar (dashboard) dhe nxënie të personalizuar.

<sup>20</sup> CKOPM (Shareable Content Object Reference Model – SCORM) është koleksion i standardeve dhe specifikimeve për teknologji edukative elektronike të bazuara në ueb (të quajtur e-nxënie ose e-trajnime ose e-përmbajtje).

<sup>21</sup> <http://wcaq.mioa.gov.mk/>

- Dërgim dhe pranim të notifikimeve.
- Kalendar i ngjarjeve.
- Përcjellje të progresit të nxënësit.
- Vegla bashkëpunuese.
- Dizajn i përshtatshëm dhe orar i objekteve në interfejs.

Paraqitje grafike e PKAD-së është paraqitur në grafikun si vijon:



Vendosja e platformës kombëtare për arsim në distancë paraqet proces serioz të transformimit të modelit të deritanishëm të arsimit dhe të gjithë qasjes së mësimit dhe nxënies jo vetëm nga aspekti i përdorimit të teknologjisë, por edhe nga aspekti i vendosjes së “pedagogjisë së re”. Prandaj, nevojitet përkushtim i plotë i institucioneve arsimore – bartësve të gjithë procesit, si dhe të gjitha palëve të përfshira dhe të prekura në procesin arsimor.

Sfidat janë të mëdha, por edhe më e madhe dhe më e rëndësishme është ideja dhe dëshira që të ndërtohet një sistem bashkëkohor, fleksibil dhe cilësor arsimor i përshtatur sipas nevojave të secilit/secilës nxënës/nxënëse në shtetin tonë.





Mësimi në distancë realizohet në një mjedis tërësisht të ri, që është ndryshim i madh në raport me mësimin në klasë, prandaj ka edhe specifikat e tij. Nocioni/koncepti sistemi mbetet, kryesisht, i njëjtë me mësimin në klasë, por në aspektin funksional ka dallime dhe zhvendosje të mëdha në kuadër të vetë orarit dhe funksioneve të mësimin. Prandaj, mund të shqyrtohen disa **karakteristika** të mësimin në distancë.

- „Trekëndëshi didaktik” dhe tre faktorët kyç të mësimin (mësimdhënës - përmbajtje - nxënës) në mësimin në distancë mund të thuhet se bëhen “pentagon didaktik” (mësimdhënës - përmbajtje -nxënës - prind - teknologji), meqë në sistemin e mësimin në distancë me nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm prindi dhe teknologjia bëhen faktorë pa të cilët mësimi nuk mund të realizohet me sukses. Në masë të madhe ndryshon edhe roli i mësimdhënësit, i cili në mësimin klasik është kryesisht ligjërues (përkundër përpjekjeve në qasjet bashkëkohore që ai të jetë lehtësues i nxënies), derisa në sistemin për mësim në distancë, para së gjithash, është mentor (mbështetës, udhëzues), ndërsa vetëm kohë pas kohe ligjërues. Prindërit ndërmarrin një varg aktivitete të organizuara të shkollës, prandaj pikërisht për këtë arsye nevojitet që të arrihen zgjidhje përmes sistemit për nxënie në distancë dhe proceseve përgatitore nga ana e sistemit arsimor në mënyrë që: (1) roli i prindit të jetë optimal dhe (2) të minimizohet rreziku – cilësia e nxënies të varet nga gatishmëria dhe mundësia e prindit që ta mësojë fëmijën e tij.
- Ka ndryshim në kuadër të vetë përgatitjeve për mësim. Në mësimin në klasë, mësimdhënësi përgatitet për mësimin, duke mbajtur llogari për “ambientin” e plotë në klasë, derisa gjatë nxënies në distancë përgatitja e mësimdhënësit fokusohet, para së gjithash, në përgatitjen e përmbajtjes. Sistemi i plotë i nxënies në distancë në masë të madhe varet nga cilësia e përmbajtjes që mësimdhënësit e përgatisin dhe ua dërgojnë nxënësve. Përmbajtjet mësimore duhet doemos të jenë të përpiluara sipas modelit të nxënies së programuar ose gjysmë të programuar, për çka mësimdhënësit nuk janë realisht të përgatitur sa duhet.
- Sistemi për mësim në distancë në masë të madhe e anashkalon dimensionin edukativ të mësimin dhe shkollës dhe këtë dimension e marrin përsipër prindërit. Dimensioi edukativ tani, kryesisht, është fokusuar në raportin ndaj punës, kohës, etj.
- Teknologjia bëhet fundamentale ashtu që nuk ka më mësim pa të.

Këto janë një pjesë e specifikave të “pedagogjisë së re” të mësimin në distancë që duhet të merren parasysh në vendosjen e sistemit të ri të mësimin në distancë ose përdorim të platformës kombëtare në punën e përditshme në shkollë.

Përvoja me qasjet novatore në përdorimin e TIK në arsim mund të jenë bazë për krijimin e “pedagogjisë së re” të mësimin në distancë. Hulumtimi i OECD-së për arsim dhe inovacione me titull „Mësimdhënësit si disenjatorë të mjedisit për nxënie”<sup>22</sup> paraqet përvoja dhe jep udhëzime për përdorimin e qasjeve novatore që mund të përshtaten në mënyrë përkatëse për nxënie në distancë.

Prandaj, në dokumentin janë ofruar gjashtë (6) grupe të qasjeve pedagogjike.

- **Nxënie e kombinuar (Blended learning).** Kjo qasje pedagogjike e kombinon punën e nxënësve dhe mësimdhënësin, e përshtatë renditjen e tyre dhe mbështetësit fortë në resurset

<sup>22</sup> [https://read.oecd-ilibrary.org/education/teachers-as-designers-of-learning-environments\\_9789264085374-en#page24](https://read.oecd-ilibrary.org/education/teachers-as-designers-of-learning-environments_9789264085374-en#page24)

digjitale. Qëllimi është që nxënia të jetë më tërheqëse dhe koherente për nxënësit dhe t'i lirojë mësimdhënësit nga të praktikuarit rutinë në favor të aktiviteteve bashkëvepruese dhe intensive në klasë. Ekzistojnë tri forma në këtë grup të qasjeve pedagogjike:

- 1) klasë e përmbysur (inverted/flipped classroom) – me ç'rast nxënësit së pari punojnë në materialet dhe më pas në kontakt me mësimdhënësit e praktikojnë, e sqarojnë në mënyrë plotësuese dhe e thellojnë mirëkuptimin/diturinë;
  - 2) model i bazuar në laboratorët (lab-based model) – ku nxënësit rrotajnë mes laboratorit të shkollës dhe klasës me zbatimin e përmbajtjes përmes bashkëveprimit ballë për ballë me mësimdhënësit;
  - 3) kombinuar në klasë (In-class blending) – ku disa nxënës të caktuar ndjekin orarin duke rrotuar mes ligjëratave të realizuara përmes internetit dhe ballë për ballë.
- **Nxënie përmes lojërave kompjuterike (Game based learning).** Mbështetet në mënyrat në të cilat lojërat mund të tërheqin interesin e nxënësve dhe të lehtësojnë nxënien. Kjo qasje është përdorur me sukses në një varg lëndësh, siç janë: Matematika, Shkenca natyrore, Edukatë fizike, gjuhë (gjuhë amtare dhe gjuhë e huaj), Histori, Art muzikor/figurativ. Ekzistojnë dy komponentë kryesorë pedagogjik: elemente mekanike (informacion të shpejtë kthyes, qëllime, pjesëmarrje dhe sfidë zhvillimore) dhe elemente emocionale (narrative dhe identitete, bashkëpunim dhe garë). Ekzistojnë një numër i madh i resurseve digjitale me elemente të lojës që janë interesante për nxënësit dhe mund të vendosen lehtë në aktivitetet për nxënie në distancë.
  - **Të menduarit kompjuterik (Computational thinking).** Zhvillon aftësi për zgjidhjen e problemeve përmes parimeve të shkencave kompjuterike. Teknikat e kësaj qasjeje përfshijnë zgjidhje të përafërta, përpunim paralel, kontroll të modeleve dhe strategji kërkimore. Elementet themelore të kësaj qasjeje janë: të menduarit logjik, dekompozimi, algoritme, abstraksion dhe skema.
  - **Të mësuarit nga përvoja (Experiential learning).** Realizohet përmes përvojës aktive, shqyrtimit dhe të menduarit. Kjo qasje i kombinon përmbajtjet dhe proceset, zvogëlon udhëheqjen, promovon angazhimin, mundëson lidhjen mes nxënies dhe mjedisit më të gjerë dhe gjeneron pasqyrë nga përvoja. Katër komponentët e kësaj qasjeje janë: përvojë konkrete, vëzhgim reflektues, konceptim abstrakt dhe eksperimentim aktiv.
  - **Të mësuarit e materializuar (Embodied learning).** I lidhë fiziken, artistiken, emocionale dhe sociale. Në hulumtimin shqyrtohen tri qasje: kulturë fizike e mbështetur në shkollë, nxënie e integruar e artit dhe kulturë e krijuesit.
  - **Arsimim i llojlojshëm dhe ligjërime i mbështetur në diskutime (Multiliteracies and discussion-based teaching).** Ka për qëllim të zhvillojë distancë kulturore dhe kapacitete kritike dhe ka të bëjë me një varg praktikash dhe parimesh në vend se me qasje të vetme pedagogjike.

Në arsimin bashkëkohor në distancë përdorimi i TIK është i pashmangshëm, por kjo ndonëse ofron shumë mundësi, vetvetiu nuk e përmirëson nxënien. "Pedagogjia e re" e mësimin në distancë nënkupton të kuptuarit e mirë të proceseve të nxënies dhe ndërlidhjen e tyre me potencialet e qasjeve novatore në nxënie me përdorimin e teknologjisë digjitale. Duhet t'i kushtohet vëmendje jo vetëm përparësive që i ofron ajo por edhe të gjendet qasja dhe mënyra më përkatëse për

përballje me sfidat e “pedagogjisë së re” në mënyrë që ajo edhe më tutje, përveç diturive dhe shkathtësive, të zhvillojë te nxënësit vlera dhe qëndrime pozitive ndaj nxënies dhe jetës.

## 1. Organizimi i mësimin në distancë

Arsimi në distancë kërkon organizim shumë të ndryshëm si në nivel të gjithë shkollës, ashtu edhe në nivel të mësimdhënësit individual. Të gjitha aktivitetet edukativo-arsimore nuk mund të adaptohen me sukses të barabartë për arsimin në distancë. Nga ana tjetër, ka një varg aktivitetesh për nxënie që mund të realizohen në mënyrë më efektive pa praninë fizike e të gjithë pjesëmarrësve në procesin arsimor.

### 1.1. Udhëzime themelore për planifikimin e mësimin në distancë

Që të mund të realizohet me sukses mësimi dhe nxënia në distancë, është i domosdoshëm planifikimi i mirë i tërë procesit. Planifikimi, para së gjithash, pritet të fillojë në nivel të shkollës, me ç’rast merren parasysh më shumë faktorë, si për shembull: nëse do të planifikohet realizimi i mësimin në distancë ose do të kombinohet me mësimin me prani fizike të nxënësve (ose si platforma do të përdoret në mësimin e rregullt), periudha për të cilën planifikohet mësimi në distancë, parakushtet që merren parasysh (teknologjia në dispozicion për mësimdhënësit dhe nxënësit, mbështetje e pritur/e mundshme ose e pamundshme nga prindërit, balancim i aktiviteteve sinkrone dhe asinkrone<sup>23</sup> etj.).

Duke marrë parasysh atë se qasja që mësimdhënësit e përdorin në planifikimin e mësimin në klasë nuk mund të jetë i zbatueshëm gjatë nxënies në distancë, është e domosdoshme që ata ta përshtatin planifikimin e mësimin në distancë, me ç’rast sërish theksi duhet të vendoset në atë që nxënësit duhet ta përvetësojnë/mësojnë.

Pasi që mësimdhënësi do t’i përcaktojë rezultatet nga nxënia (çfarë duhet të mësojnë nxënësit) në bazë të programit mësimor, me planifikimin do ta përcaktojë mënyrën përkatëse (aktivitetet, metodat dhe teknikat, përdorimin e veglave, mjeteve të caktuara, etj.) si do ta realizojë këtë në distancë, si do t’i përcjellë përparimin dhe notimin e nxënësve dhe do të parashikojë mënyra për realizimin e aktiviteteve me nxënësit dhe prindërit.

Gjithashtu, mësimdhënësi duhet t’i inkurajojë nxënësit që të bëjnë plane të tyre për punë, eventualisht së bashku me prindërit, meqë gjatë nxënies në distancë rritet përfshirja e prindërve/kujdestarëve në nxënien e fëmijëve të tyre, ndërsa nxënësit mund t’i përzgjedhin “shtigjet e tyre të nxënies”, qasje dhe mjedise sipas gjendjes së tyre momentale.

Planifikimi i nxënies në distancë do të jetë i suksesshëm nëse të gjithë e përdorin për mbështetje të nxënies (edhe mësimdhënësit, edhe nxënësit, edhe prindërit).

---

<sup>23</sup> Aktivitete sinkrone janë ato kur mësimdhënësit dhe nxënësit komunikojnë në kohë reale përmes mediave elektronike në mënyrë verbale ose me shkrim (për shembull, video-thirrje/audio-thirrje, çet). Aktivitete asinkrone janë ato kur komunikimi nuk zhvillohet në kohë reale, por vijuese. Mund të jetë porosi verbale (për shembull, dërgim të video-porosisë/audio-porosisë) ose porosi me shkrim (për shembull, dërgim/vendosje të platformës, dokumenteve me udhëzime për punë), por mund të jetë edhe kërkim i informacionit plotësues për detyrë të kryer përmes telefonit.

Më e rëndësishme është që me planifikimin të parashikohen edhe notimi formativ, ndjekja, vlerësimi dhe realizimi i qëllimeve të caktuara që do ta bëjnë nxënien “të dukshme”, dhënien e informacioneve kthyesë, kështu që nxënësit do të dinë se kur janë arritur rezultatet nga nxënia dhe të njëjtat do të jenë “të dokumentuara”.

## **1.2. Organizimi i mësimit – përpilim i orarit të orëve për nxënie në distancë**

Kur bëhet fjalë për mënyrën e organizimit të mësimit, gjegjësisht përpilimin e orarit për nxënie në distancë, këtë aktivitet duhet ta planifikojë çdo shkollë ndaras (varësisht nga numri i nxënësve, gjuha/gjuhët në të cilën/cilat zhvillohet mësimi, sukcesi i përgjithshëm i nxënësve dhe faktorë të tjerë) dhe do të përzgjedhë mënyrën më përkatëse në të cilën do ta realizojë mësimin në distancë, edhe atë:

- shkolla të respektojë orarin që përpilohet për një vit konkret shkollor (kur mësimi zhvillohet në shkollë) – secili mësimitdhënës/profesor mban mësim në përputhje me orarin vjetor të klasave/paraleleve (për shembull: mënyra e këtillë mund të jetë e zbatueshme për shkollat e mesme, por edhe për shkolla fillore me numër të madh të paraleleve dhe numër të madh të nxënësve në paralele, për shembull prej 25 deri 30 nxënës);
- Shkolla të përpilojë orar të ri që do të vlejë vetëm për ndjekjen e mësimit në distancë (ose për mësim të kombinuar, që do të realizohet një pjesë në shkollë, një pjesë në distancë) dhe që do të lejojë grupimin e paraleleve nga klasa e njëjtë, gjegjësisht klasat e vitit të njëjtë, me ç’rast mësimitdhënësi/professori do të realizojë mësim njëherësh me paralelet e klasave/paraleleve të vitit të njëjtë në të cilat ai realizon mësim (për shembull: mënyra e këtillë mund të jetë e zbatueshme për shkollat fillore të cilat kanë numër të vogël të paraleleve dhe paralele me numër të vogël të nxënësve, paralele të kombinuara, ose, nga ana tjetër, në disa nga shkollat e mesme profesionale të cilat kanë klasa me numër të vogël të nxënësve).

Gjatë përzgjedhjes së orarit në të cilin do të realizohet mësimi në distancë duhet të merret parasysh, para së gjithash, mirëmbajtja e cilësisë së mësimit dhe mundësia që nxënësit të jenë të motivuar dhe të përfshihen në mënyrë aktive në të njëjtin.

## **1.3. Koha për realizimin e mësimit në distancë**

Në nxënien në distancë veçanërisht duhet pasur kujdes në angazhimin aktiv të nxënësve. Duhet të respektohet orari i përcaktuar i nxënies në distancë, realizimi i mësimit, përmbajtjet mësimore, si dhe detyrat për punë të mëvetësishme nxënësit t’i marrin në kohë të caktuar (në përputhje me orarin). Kjo është e rëndësishme në mënyrë që nxënësit të mund të organizojnë kohën e tyre, të “ndjejnë” se janë në një kohë të caktuar të “mësimit në distancë” dhe të mund të planifikojnë kohën e tyre të lirë.

Rekomandohet që mësimi në distancë të realizohet paradite, me çka do të mundësohet që nxënësit të mësojnë në mënyrë të mëvetësishme dhe t’i bëjnë detyrat që i kanë marrë në periudhën

e paradites. Por, kuptohet, lihet hapësirë, secila shkollë varësisht nga kushtet të bëjë orarin e saj për realizimin e mësimit, me ç'rast do të duhet t'i informojë me kohë nxënësit dhe prindërit për orarin.

Koha e parashikuar për mësime gjatë një dite duhet të jetë e përshtatur me moshën dhe nivelin e vëmendjes së nxënësve. Si rezultat, nxënësit e mësimit klasor duhet të kenë më së shumti 120 minuta mësime dhe nxënie në distancë brenda ditës (pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për aktivitete sinkrone ose asinkrone), nxënësit e mësimit lëndor prej 120 deri në 180 minuta, derisa nxënësit e shkollave të mesme prej 180 deri në 240 minuta<sup>24</sup>. Kjo nënkupton se mësimeve, gjatë përgatitjes së aktiviteteve, do t'i kenë parasysh këto periudha kohore dhe do të sinkronizojnë orarin dhe kohëzgjatjen e orëve/aktiviteteve sipas ditëve në nivel të shkollës.

Shkollat mund të rekomandojnë kohë për aktivitete të ndryshme, siç janë: lexim, aktivitete kreative/krijim, hulumtim, etj., ndërsa gjithashtu, varësisht nga mosha e nxënësve, të parashikojnë një kohë të caktuar (prej 30 minutave për nxënësit e mësimit klasor, 60 minuta për nxënësit e mësimit lëndor, deri 90 minuta për nxënësit e shkollave të mesme) për të bërë detyrat e shtëpisë, si dhe kohë për përsëritje, plotësim të ditëve reflektues, etj.

Rekomandohet një orë e mësimit në distancë të mos jetë më e gjatë se 30 minuta, ndërsa nxënësit të kenë pushim më së paku 5 deri 10 minuta ndërmjet secilës orë.

## 2. Realizimi i mësimit

Mësimeve duhet t'i përshtatin planifikimet e mësimeve dhe kohës, metodat dhe mënyrat e realizimit të mësimit në distancë. Rekomandohet që prezantimi i përmbajtjes së re mësimore të mos jetë më shumë se gjysma e kohës së parashikuar të orës, gjegjësisht rreth 15 minuta (pa marrë parasysh nëse mësimeve do të prezantojë vetë ose do të shfrytëzojë leksionet e vendosura në platformën kombëtare), ndërsa minutat e mbetura të orës (10 – 15 minuta) mësimeve t'i shfrytëzojë për komunikim me nxënësit në një temë që është e rëndësishme në atë moment dhe për të cilën nxënësit kanë treguar interes, për pyetje nga nxënësit, sqarime plotësuese, vetënotim, dhënie të informacioneve kthyes, etj.

Në mënyrë që të nxitet dhe mbështetet nxënia e vetëudhëzuar, rekomandohet që mësimeve t'u japin nxënësve aktivitete (projekte) më afatgjata të udhëhequra nga interesat e tyre individuale, në vend të aktiviteteve afatshkurtra. Në këtë mënyrë nxënësit zhvillojnë kompetenca më të ndërlikuara, ndërsa mësimeve mund të fokusohet drejt përcjelljes së përparimit dhe udhëzimit të nxënësve. Detyrat e këtyra duhet të jenë të strukturuar mirë në aspektin e përmbajtjes dhe kohës dhe të ndjeket përparimi përmes bërjes së detyrave dhe arritjes së qëllimeve në afate të përcaktuara kohore.

Për mënyrën e punës gjatë aktiviteteve të sinkronizuara, nevojitet që mësimeve t'i informojë nxënësit dhe t'i përcaktojë "rregullat" me ta (si parashikohet pyetje, si lajmërohet për fjalë, sa kohë prezantohet, etj.). Gjithashtu, për aktivitete asinkrone duhet të ekzistojnë rregulla – ku vendosen

---

<sup>24</sup> Në kohën e parashikuar nuk nënkuptohen aktivitete e mëvetëshme të nxënësit.



detyrat e përpiluara, ku dhe si parashtrohen pyetje, ku dhe si përgjigjet në pyetjet e parashtuara nga mësimitdhënësi dhe/ose bashkënxënësit, kur dhe si merret informacion kthyes.

Të gjitha materialet për një orë të caktuar (fleta mësimore, detyra të shtëpisë, prezantime/plan i përmbajtjeve të caktuara mësimore, linqe për video-leksionet e regjistruara) mësimitdhënësi i vendos në platformë më së voni deri në fund të ditës kur është realizuar një përmbajtje e caktuar. Nëse mësimitdhënësi e ka përgatitur materialin, nëse kjo është përkatëse, mund ta vendosë edhe disa ditë para realizimit të përmbajtjes mësimore.

Detyrat e shtëpisë/ detyrat e mëvetësishme për nxënësit që i jep mësimitdhënësi duhet të jenë të "dimensionuara" në përputhje me moshën e nxënësve (gjatë angazhimit për zgjidhjen e tyre të mos u merret më shumë se gjysmë ore nxënësve më të vegjël, në periudhën e parë të shkollës fillore, më shumë se një orë për nxënësit deri në fund të shkollës fillore, gjegjësisht jo më shumë se një orë e gjysmë për nxënësit e shkollave të mesme, përveçse kur bëhet fjalë për projekte hulumtuese ose disa punime praktike për të cilat është e domosdoshme një kohë më e gjatë për përpilim).

Numri i orëve nga një lëndë e caktuar është në përputhje me planet e përcaktuara mësimore dhe programin mësimor për secilën lëndë mësimore.

Mësimitdhënësi gjatë realizimit të mësimin duhet të përdorë sistem për shënimin e pranisë së nxënësve në mësim, rregullsinë dhe të qenët me kohë në përmbushjen e detyrave.

Nevojitet që secili mësimitdhënësi të zhvillojë strategji dhe të përcaktojë mënyra të mbështetjes për nxënësit me aftësi të kufizuara. Për këtë nevojitet koordinim i shkëlqyeshëm mes mësimitdhënëseve, asistentëve dhe bashkëpunëtorëve profesional. Varësisht nga nevojat e nxënësit duhet të përcaktohet se cili ritëm i punës është më adekuat, nëse më shumë peshë duhet të vihet në leksionet të sinkronizuara sesa atyre asinkrone, në çfarë mënyre mund të modifikohen detyrat dhe cili lloj i teknologjisë ndihmëse është i nevojshëm (font i posaçëm, lexues, klik i posaçëm, xhojstik, etj.).

## **2.1. Përdorimi i e-përmbajtjeve**

Mësimitdhënësi gjatë realizimit të nxënies në distancë ose, nga ana tjetër, gjatë përdorimit të platformës për realizimin e mësimin në klasë përdorë e-përmbajtje. Mësimitdhënësi vetë mund të përgatisë/përshtatë përmbajtje përkatëse për lëndën mësimore në të cilën e realizon mësimin ose të përdorë e-përmbajtje të përpunuara që janë në dispozicion të platformës.

E-përmbajtjet përdoren në mënyrë që të nxitet interesimi i nxënësve për lëndën mësimore, të mbahet mend dhe të kuptohet më lehtë një përmbajtje e caktuar, si dhe të zbatohet dituria e përvetësuar. E-përmbajtjet që mësimitdhënësi i përpunon ose i përzgjedhë duhet të jenë multimediatike, gjegjësisht të kenë tekst, animim, tingull, prezantim, të jenë të kapshme në platformën që përdoret në klasë, por edhe të jenë të kapshme për nxënien në distancë. E-përmbajtjet e përpiluara duhet të përkojnë me moshën e nxënësve dhe qëllimet/rezultatet e pritura nga programi mësimor.

E-përmbajtjet, në përgjithësi, mund të ndahen sipas elementeve nga aspekti teknik dhe elementeve nga aspekti i përdorimit. Kështu, nga aspekti teknik, e-përmbajtjet mund të përbëhen prej kategorive vijuese të elementeve:

- **prezantime,**
- **prezantime bashkëvepruese,**
- **animime,**
- **simulime,**
- **video-shënime,**
- **audio-shënime,**
- **diagrame,**
- **harta,**
- **tekste.**



E-përmbajtjet (siç janë: prezantimet tekstuale, audio dhe video-prezantimet dhe e-përmbajtjet tjera më të thjeshta) mësimdhënësi i përpilon dhe i vendosë në platformën dhe ato mund të jenë në dispozicion edhe në shkollë gjatë realizimit të mësimit dhe nxënies në distancë.

Gjithashtu, në platformën vendosen e-përmbajtje më komplekse të furnizuara dhe aprovuara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim dhe Qendra Shtetërore e Provimeve, që janë në përputhje me programet mësimore, e që kanë për qëllim të “zëvendësojnë” ligjërimin e një njësie të caktuar mësimore (video-leksione të regjistruara nga mësimdhënësit të shoqëruara me prezantimin) ose t’i zgjerojnë dhe thellojnë dituritë e nxënësve, t’i përmirësojnë të arriturat e nxënësve, të bëjnë kontrollimin e diturive dhe arritjeve të nxënësve. Edhe këto e-përmbajtje janë të kapshme për mësimdhënësit dhe nxënësit në shkollë, si dhe gjatë organizimit dhe realizimit të mësimit dhe nxënies në distancë.

### 3. Ndjekje dhe notim i nxënësve gjatë nxënies në distancë

Strategjitë për vlerësimin e arritjeve/përparimeve të nxënësve gjatë mësimit në distancë duhet të jenë të përshtatura me rezultatet nga nxënia nga programi mësimor. Me këtë rast, ato varen edhe nga përzgjedhja e metodave mësimore dhe instrumenteve për notim, si dhe nga veglat dhe modelet e notimit.

#### 3.1. Notimi formativ gjatë mësimit në distancë

Në nxënien në distancë janë zvogëluar dukshëm mundësitë për kontakt të drejtpërdrejt verbal dhe vizual dhe kontroll të situatës. Prandaj, nevojitet përshtatje e notimit formativ dhe sumativ të situatës së re dhe nxënësve t’u jepen **udhëzime të qarta lidhur me notimin** (si të mësojnë në mënyrë të mëvetëshme, si të kontrollojnë se sa kanë mësuar, cilat dëshmi duhet t’i mbledhin, si do të kontrollohet ajo që është mësuar, si do të formohet nota).

Mësimi në klasë virtuale është sfidë dhe mundësi për të bërë një hap para në notim në drejtim të vënies së theksit në proceset më të ndërlikuara kognitive (analizë, sintezë, vlerësim) në vend se në

përvetësimin e diturisë faktografike, që është, në fakt, edhe qëllim i arsimit. Kjo do të thotë edhe se në mësimin dhe notimin në distancë **theksi duhet të vihet në atë që është e rëndësishme**<sup>25</sup>.

Për nxënie të suksesshme në distancë nxënësve u janë të domosdoshme informacione për suksesin e tyre, si dhe udhëzime për përmirësim. Notimi formativ ua siguron informacionet e tilla, e njëherësh i ndihmon mësimdhënësit që t'i përshtatë aktivitetet mësimore dhe me këtë të përmirësohet nxënia e nxënësve. Në notimin formativ në distancë informacioni kthyes në të shumtën e rasteve nuk jepet në mënyrë të sinkronizuar (njëherësh), por prandaj i dhënë në mënyrë të prolonguar ai mund të jetë më i detajuar dhe më konkret. Notimi formativ përmes internetit (onlajn) i ka përparësitë e njëjta si edhe në klasë reale.

Nxënia në distancë është mundësi e shkëlqyeshme që nxënësit të marrin përsipër përgjegjësi për nxënien personale, të planifikojnë dhe të aftësohen për nxënie të mëvetësishme, me atë që u lihet më shumë kohë dhe mundësi që vetë ta organizojnë nxënien, e edhe t'i përmirësojnë punimet pas komenteve që i marrin.

Hapat më të rëndësishëm në notimin formativ mund të adaptohen lehtë me situatën në klasën virtuale, thuajse në mënyrë të pavarur nga veglat elektronike që përdoren në mësim.

- **Njoftim me qëllimet e nxënies dhe rezultatet e pritura nga nxënia.** Gjatë aktiviteteve të sinkronizuara nxënësit informohen gojarisht se çfarë do të mësojnë dhe çfarë do të mund të bëjnë në fund të një ose më shumë aktiviteteve. Në aktivitetet josinkrone duhet në formë të shkruar ose përmes video-porosisë/audio-porosisë së regjistruar t'u shkruhet/thuhet nxënësve se çfarë duhet të mësojnë, se cilët hapa në nxënien duhet t'i bëjnë dhe si do të tregojnë në fund se kanë mësuar. Është mirë që ky informacion të ndahet edhe me prindërit/kujdestarët me çka do të sigurohet që ata të përfshihen më shumë në nxënien e fëmijës së tyre dhe do të tejkalohen mosmarrëveshjet eventuale në notimin për shkak të dallimeve në pritjet për atë që duhet të mësohet.
- **Parashtrim i pyetjeve dhe detyrave përmes të cilave mund të shihet të kuptuarit e asaj që mësohet.** Në aktivitetet e sinkronizuara mund të parashtrihen pyetje të shkurtra të nxënësve konkretë, por edhe të grupit të tërë (për shembull: përgjigje në pyetje të shkurtra me shenja për e saktë-e pasaktë, përmbledhje e përmbajtjeve të mësuara paraprakisht në një fjali). Mund të përdoret edhe komunikim i drejtpërdrejt (përmes telefonit ose çetit) në mënyrë që të kontrollohet se çfarë di nxënësi, e çfarë jo, dhe me kohë t'i jepen udhëzime për nxënie, materiale plotësuese, të lidhet me nxënës të tjerë, etj. Në aktivitetet josinkrone mund të përpilohen rrënjësisht pyetjet, kështu që krahas pyetjeve për kontrollim se sa dhe si kanë mësuar nxënësit, mund të ketë edhe pyetje për kontroll se sa dhe si kanë mësuar nxënësit dhe pyetje plotësuese të llojit: Çfarë është më e rëndësishme nga ajo që e mësove?; Çfarë nuk ke mjaft të qartë?
- **Përdorim i metodave dhe teknikave të llojllojshme për kontrollim.** Zbatohen të gjitha metodat e bazuara në notimin e punimeve me shkrim (eseje, disa lloje të projekteve, prezantimeve, testeve), e veçanërisht janë të zbatueshme ditarët reflektues. Por, ekzistojnë

---

<sup>25</sup> Faktet janë lehtë të kapshme përmes mediave të ndryshme elektronike, që nxënësit në fund të arsimit fillor dhe në fillim të arsimit të mesëm tashmë i përdorin me sukses, por duhet të mësojnë se si të përzgjedhin burime relevante, si t'i krahasojnë, analizojnë dhe vlerësojnë informacionet dhe në bazë të asaj të miratojnë konstatime dhe të formojnë qëndrime.

kufizime në përdorimin e metodave të veçanta të ndjekjes, për shembull: mbikëqyrje të realizimeve praktike. Është mirë që të mos përdoren një numër tepër i madh i teknikave të notimit në mënyrë që të vendoset një rutinë e caktuar në përdorimin e teknikave të përzgjedhura.

- **Përfshirje të nxënësve në notimin (vetënotimin dhe notimin e ndërsjellë) për shkak të nxënies prej njëri-tjetrit.** Notimi i ndërsjellë duhet të përfshihet në aktivitetet e sinkronizuara dhe në disa lloje të aktiviteteve josinkrone (për shembull: grupe të mbyllura për diskutim në rrjetet sociale, komentet e shkruara të punimeve të shkruara nga bashkënxënësit). Vetënotimi është më adekuat të bëhet në detyrat e përpiluara me shkrim përmes përgjigjes në pyetjet për vetëreflektim të llojit: Më së shumti jam i kënaqur me... Mendoj se mundem më mirë... Gjëja e radhës që do ta bëj është...

### 3.2. Informacion kthyes gjatë nxënies në distancë

Informacioni kthyes gjatë nxënies nga distanca është veçanërisht i rëndësishëm në mënyrë që të mirëmbahet motivimi dhe vazhdimësia në nxënien. Në fillim, mësimdhënësi në bazë të mundësive të disponueshme teknike nga nxënësit, si dhe mundësive dhe kompetencave personale, duhet t'i përcaktojë mënyrat më adekuate për komunikim me nxënësit, dhe si rezultat i kësaj – të japë informacione kthyes.

Informacioni kthyes mund të jepet në forma të ndryshme. Gjatë dhënies josinkrone të informacionit kthyes, i njëjti mund të jetë në:

- **Formë të shkruar** – përmes opsioneve të ndryshme për dhënien e komenteve në vetë dokumentin që e dërgon nxënësi, ose, nga ana tjetër, i veçuar në dokument të posaçëm që nxënësi e merr mbrapa përmes mekanizmit të vendosur të komunikimit (onlajn platformë për mësim, rrjetë sociale, postë elektronike, etj.). Informacioni kthyes i shkruar është metoda më përkatëse për disa lëndë të caktuara (për shembull: matematikë, shkencë natyrore) dhe lloje të caktuara të detyrave (për shembull: detyra matematikore, pyetje për test), por mund të përdoret me sukses edhe për lëndë të tjera (për shembull: gjuhë amtare/e huaj, lëndë mësimore nga shkencat shoqërore) gjatë notimit të pyetjeve të eseve.
- **Audio-formë ose video-formë.** Mësimdhënësi mund ta regjistrojë informacionin kthyes dhe t'ia dërgojë nxënësit në formë të video-regjistrimit ose audio-regjistrimit. Kjo qasje është përkatëse nëse informacioni është i hollësishëm dhe shumë specifik dhe ka për qëllim të ndikojë veçanërisht në aspektet socio-emocionale të motivimit. Njëherësh, është më e sigurt se do të jetë e kuptuar në mënyrë përkatëse, meqë përfshin edhe informacion joverbal (toni i zërit).

Dokumentet/regjistrimet që përmbajnë informacion kthyes mësimdhënësi mund t'i përfshijë shumë thjeshtë në portofolin elektronik të nxënësit dhe t'i shfrytëzojë për përcjelljen e përparimit të nxënësit, si dhe për notimin sumativ.

Gjatë dhënies së informacionit kthyes në mënyrë të sinkronizuar, më përkatëse është **biseda e drejtpërdrejt me nxënësin** përmes telefonit ose aplikacioneve onlajn për komunikim (që i mundëson platforma ose aplikacione të tjera që do t'i përdorin shkollat, etj.). Meqë mënyra e këtillë e dhënies së informacionit kthyes kërkon më shumë kohë nga mësimdhënësi, është mirë që ai/ajo

në orarin të parashikojë sesione individuale për dhënien e informacionit kthyes në një pjesë të caktuar të ditës ose javës. Sesionet e këtilla mundësojnë që nxënësit ta ruajnë kontaktin dhe lidhjen me shkollën dhe ndjenjën se mësimdhënësit u janë në dispozicion në mënyrë që t'u japin udhëzim dhe mbështetje.

Informacioni kthyes mund të jepet edhe në nivel të gjithë klasës/paraleles në mënyrë që të theksohet përparimi ose, nga ana tjetër, të bëhen të ditura disa sfida të caktuara me të cilat përballen të gjithë/shumica nxënësit/e nxënësve. Sërish, kjo mund të jetë në formë të shkruar ose audio-formë/video-formë.

Krahas kontrollit të asaj që është mësuar dhe qëllimeve të arritura nga programi mësimor, është mirë që mësimdhënësi kohë pas kohë të parashikojë mundësinë që nxënësit të japin informacion kthyes edhe për nxënien socio-emocionale, përmes kërkimit të informacionit kthyes nga ana e nxënësve lidhur me çështjet si: Çfarë funksionon mirë/u pëlqen gjatë nxënies në distancë?; Çfarë mund të përmirësohet?; Çfarë do të rekomandonit? Në këtë mënyrë mësimdhënësi do të mund ta përshtatë mënyrën e punës në mënyrë përkatëse me nevojat dhe mundësitë e nxënësve. Informacionet e këtilla mund t'i mbledhë edhe gjatë sesioneve të sinkronizuara (për shembull: orë që mbahet përmes ndonjërit nga rrjetet për takime), ashtu që gjatë orës do të kërkojë prej nxënësve që me shkrim të përmendin se sa e kuptojnë materialin në të cilin punohet, për shembull: përmes përgjigjeve po – jo në fushën e komunikimit me shkrim ose, nga ana tjetër, porosi të drejtpërdrejt deri te mësimdhënësi.

**Informimi i prindërve/kujdestarëve** është një lloj i informacionit kthyes duke marrë parasysh pritjet që ata të jenë të përfshirë më shumë në nxënien në distancë. Prindërit duhet të informohen për pritjet e nxënësve, detyrat që (do t') i marrin, suksesin në kryerjen e tyre, udhëzimet për punë të mëtejshme. Pritet që prindërit të jenë të informuar mirë për nxënien e fëmijës. Mësimdhënësi duhet veçanërisht të përpiqet të vendosë kontakt edhe me prindërit që nuk tregojnë interesim për nxënien e fëmijës.

**Vetëreflektimi i mësimdhënësit** është kyç për përmirësimin e arsimit në distancë, për shkak se u mundëson mësimdhënësve që t'i vlerësojnë dhe përmirësojnë qasjet që i kanë përdorur. Të dhënat e grumbulluara për nxënien e nxënësve duhet të shfrytëzohen për përmirësimin e nxënies së tyre dhe/ose për përmirësimin e mësimdhënies.

### 3.3. Notim sumativ

Notimi sumativ është pjesë e thujtë çdo lloji të arsimit formal, pa marrë parasysh mënyrën në të cilën realizohet. Sfidë e veçantë në notimin sumativ në arsimin në distancë është siguri i besimit se kjo është e vlefshme dhe korrekte. Ekzistojnë përvoja dhe mënyra se si të sigurohet notim cilësor sumativ në mësimin në distancë.

- **Vlefshmëri** (kontroll i të gjitha rezultateve nga nxënia). Sigurohet në atë mënyrë që kontrollohen vetëm ato rezultate të pritura për të cilat nxënësit janë mësuar përmes nxënies në distancë. Gjatë përzgjedhjes së metodave të notimit merren parasysh edhe metodat përmes të cilave nxënësit janë mësuar.

- **Besueshmëri** (sa i reflekton nota arritjet e nxënësit). Nivel i kënaqshëm i besueshmërisë së notës në notimin në distancë mund të sigurohet nëse jepen detyra autentike që e vështirësojnë mundësinë për gjetjen e përgjigjeve të gatshme në materialet mësimore ose në burime të tjera të informacioneve, ndërsa në detyrat me të cilat kontrollohet njohja dhe të kuptuarit e fakteve duhet të sigurohet kontroll i kohës për zgjidhjen e detyrave. Gjithashtu, në mënyrë vijuese, në kontakt të drejtpërdrejt mësimdhënësi mund të kërkojë sqarime plotësuese në mënyrë që të bindet në besueshmërinë e përgjigjeve. Te mësimdhënia e sinkronizuar mund të sigurohet edhe kontroll i sjelljes. Për shkak të sigurimit të besueshmërisë më të madhe të notave sumative, rekomandohet edhe përdorimi i njohurive nga notimi formativ (notim i punimeve më të mira/portofol reprezentativ) gjatë formimit të tyre.
- **Objektivitet** (nëse gjatë notimit të sërishëm nxënësi do të merrte notën e njëjtë). Objektiviteti i notave sigurohet nëse në mënyrë konsekuente respektohen kriteret konkrete për notim të përpiluar paraprakisht (kriteret të përkufizuara për çështje të eseve, përgjigje të qarta të test-detyrat) dhe zbatimin e tyre të përpiktë nga mësimdhënësi. Nëse paraprakisht ndahen me nxënësit dhe prindërit rubrikat për notimin e projektit ose esesë ose lista e pikëve për përgjigje të shkurtra të eseve, do të rritet edhe besimi i nxënësve dhe prindërve se notimi është objektiv.
- **Drejtësi/paanshmëri**. Notimi objektiv njëherësh është edhe i paanshëm/ i drejtë (në notën nuk ndikojnë faktorë të tjerë që nuk kanë të bëjnë me atë që notohet, për shembull: gjinia, prejardhja sociale). Mirëpo, në notimin në distancë nëse të gjithë nxënësit nuk kanë aparate elektronike po aq të mira, kjo mund të ndikojë në cilësinë e detyrës (për shembull: disa kanë kompjuter, e disa të tjerë, telefon celular), prandaj detyrat për notim sumativ duhet të jenë të tilla në mënyrë që të mos u japin përparësi atyre që kanë aparate më të mira (për shembull: prezantimi teknik të mos jetë kriter ose të gjithë të zgjidhin testin në mënyrë të njëjtë – ose në letër ose në kompjuter). Në notën nuk duhet të ndikojnë as përshtypjet e mësimdhënësit për nxënësit. Ndodhë që nxënia në distancë t'u përgjigjet disa nxënësve që paraprakisht kanë arritur rezultate më të dobëta që mund të befasojnë me cilësinë e punimeve të tyre. Kjo duhet të vlerësohet në mënyrë përkatëse.
- **Transparencë/qartësi dhe opinion** (nxënësit janë të njoftuar me mënyrën e notimit). Nxënësit dhe prindërit duhet të njoftohen me atë që nxënësit duhet ta arrijnë dhe si do të notohet ajo: me çfarë detyra, cilat do të jenë kriteret, si do të jepen pikat. Mësimdhënësi mund të bëjë tabelë për dëshmi/produkte që nxënësi do t'i dorëzojë si pjesë e portofolit elektronik që do të notohet – çfarë duhet të tregojnë, deri kur dhe si të dorëzohen dhe t'i informojë në mënyrë përkatëse për këtë nxënësit dhe prindërit (përmes vendosjes së platformës së caktuar, dërgim përmes postës elektronike ose përmes grupit në aplikacion të caktuar). Nxënësit duhet t'i kenë në dispozicion rubrikat dhe kriteret për notimin e eseve, t'u sigurohen teste për ushtrim me pyetje të eseve të ngjashme me ato që do të përdoren. Gjithashtu, duhet të informohen edhe për atë se sa do të kenë ndikim në notimin sumativ të arritjeve nga detyra e esesë dhe/ose projektit, njohuritë për punimet më të mira në portofolin elektronik ose testin eventual vjetor. Është mirë që një peshë e caktuar t'i jepet edhe rregullsisë dhe përmbushjes së detyrave.

Matjet e jashtme dhe provimet në nivel kombëtar duhet t'i përshtaten administrimit onlajn për çka do të përpilohen edhe protokolle përkatëse.

### 3.4. Metoda dhe teknika të notimit gjatë mësimdhënies në distancë

Teknika më të shpeshta digjitale që mund t'i përdorin mësimdhënësit në mënyrë që të vlerësohet përparimi dhe arritjet e nxënësve, gjegjësisht teknika më të shpeshta digjitale për notim formativ dhe sumativ, varësisht nga performanset e platformës përkatëse, janë:

- **Testet objektiv me përzgjedhje të përgjigjeve të ofruara.** Të gjitha llojet e testeve objektive me përgjigje të ofruara (me përzgjedhje të shumëfishtë, përzgjedhje të përgjigjes së saktë prej dy të ofruara, teste me ndërlidhje) janë të përshtatura lehtë për notim onlajn. Përparësia e testeve të këtilla është se janë të lehta për administrim. Notimi është krejtësisht objektiv, menjëherë merren rezultatet që janë në dispozicion për nxënësin dhe për mësimdhënësin. Lehtë bëhet analizë e detyrave të zgjidhura saktë dhe josaktë, llojit të gabimeve, etj.
- **Teste me përgjigje të shkurtër.** Këto test-detyra kërkojnë nga nxënësi që të plotësojë fjalë ose frazë si përgjigje të pyetjes së drejtpërdrejt ose të futë fjalë ose frazë që ka mbetur jashtë deklaratës. Janë të lehta për përpilim dhe nuk janë shumë të vështira për notim. Siç është rasti me testet me përgjigje të ofruara, ka shumë vegla që janë të ofruara për gjenerimin e testeve me përgjigje të shkurtër.
- **Pyetje të eseve.** Esetë mundësojnë që të vlerësohen dituri, aftësi dhe shkathtësi për nxënie të nivelit më të lartë. Megjithatë, ato u marrin shumë kohë mësimdhënësve për kontrollimin e tyre. Eseja që do të përdoret për notim sumativ duhet të përpilohet mirë dhe të gjithë nxënësit ta punojnë në kohën e njëjtë të kontraktuar paraprakisht. Nëse esetë dorëzohen onlajn, mund të jetë më lehtë që të kontrollohen për përdorimin e skemës për vlerësim me model të përgjigjeve. Njëra prej përparësive më të rëndësishme për zgjidhjen e pyetjeve të eseve onlajn për notim formativ është mundësia që mësimdhënësi të kontrollojë progresin në punë dhe të japë komente në tekstin e dorëzuar nga nxënësi në platformën.
- **Lojëra onlajn.** Lojërat onlajn ofrojnë mundësi emocionuese nxënësve për nxënie dhe janë të përshtatshme për ndjekjen e përparimit dhe për notim. Ato mund të sigurojnë rrethim kreativ në të cilin nxënësit mund të mësojnë të eksperimentojnë, të bashkëpunojnë dhe të zgjidhin probleme. Mund të përdoren në thujtë të gjitha lëndët mësimore, e, para së gjithash, për notim formativ.
- **Revista të nxënësve, bllogim dhe ndërtim viki (wiki).** Shumë platforma sigurojnë funksionalitete për gazetari të nxënësve, bllogim ose ndërtim viki (wiki). Gjithashtu, ekzistojnë vegla që janë falas në internet. Revista është vegël veçanërisht e rëndësishme për nxitjen e të menduarit të nxënësve, ndërsa mësimdhënësit mund të përzgjedhin që t'i notojnë shënimet në revistat me ndihmën e rubrikave. Revistat zakonisht janë private, të dukshme vetëm për kuadrin mësimdhënës dhe për çdo nxënës individual.

Bllogimi është i ngjashëm me revistën, përveç asaj që ka më shumë karakteristika për sigurimin e qasjes deri te informacionet. Një ose më shumë nxënës mund të bëjnë bllogje private, gjysmë-private ose publike. Bllogjet mund të notohen në mënyrë të njëjtë si edhe revistat.

Viki (wiki), gjithashtu, janë vegla që mund t'i krijojnë një ose më shumë nxënës dhe mund të jenë konstruktive si private, gjysmë-private ose publike. Viki (wiki) janë veçanërisht të dobishme për projekte grupore për bashkëpunim dhe janë të përshtatshme për nxënie sociale konstruktive.

- **Portofoli elektronik** është vegël e domosdoshme për notimin në distancë për shkak se i mundëson nxënësit që ta përcjellë përparimin personal, të përmirësohet dhe të dokumentojë përparimin. Kjo i mundëson të ruajë lloje të ndryshme të punimeve, në mesin e të cilave edhe ato multimediatike. Mësimdhënësit, nga ana tjetër, i mundëson të përcjellë nxënësin, ta notojë në mënyrë formative dhe sumative dhe ta dokumentojë notimin. Onlajn portofoli mund të përpunohet me përdorimin e TIK-veglave më të ndryshme. Këto vegla u mundësojnë nxënësve që të shkruajnë dokumente dhe të vendosin fotografi, audio dhe video-materiale. Përmbajtja e përgjithshme mund të shënohet dhe, nëse paraqitet nevoja, të shpërndalet në vegla dhe media të tjera. Përparimi më i rëndësishëm për krijimin e portofolit digjital është mundësia që të përfshihen përmbajtje më të ndryshme, si për shembull: filma, audio-regjistrime, prezantime, tekst, hiperlinqe dhe animime. Përdorimi i veglave onlajn për e-portofol mundëson dokumentimin e arritjeve të nxënësve të detyrat e ndërlikuara ku pritet që nxënësit të krijojnë, kompozojnë, konstruktojnë, dizajnojnë, gjenerojnë, shpik dhe të prodhojnë.

Në matjet dhe provimet e jashtme në të shumtën e rasteve përdoren test-detyra objektive, pyetje të eseve me përgjigje të shkurtra dhe ese të shkruara që janë të shoqëruara me udhëzime të hollësishme dhe rigorozë për notim.

#### **4. Bashkëpunimi dhe mbështetja nga prindërit/kujdestarët gjatë realizimit të mësimdhënies dhe nxënies në distancë**

Duke marrë parasysh faktin se në procesin e nxënies në distancë mësimdhënësit më nuk janë të pranishëm fizikisht në mënyrë që të mund t'i udhëzojnë vazhdimisht dhe ta përcjellin përparimin e nxënësve, nevojitet të sigurohen mënyra përkatëse të komunikimit dhe t'ua sqarojnë nxënësve qëllimet/rezultatet nga nxënia në mënyrë që vetë të mund të planifikojnë nxënien me ndihmën e prindërve ose me ndonjë mbështetje tjetër.

Shumica e prindërve/kujdestarëve mund të jenë "lehtësues" të mirë në nxënien në distancë, por mund të krijojnë edhe barriera të panevojshme, për shembull – nëse i mësojnë nxënësit e tyre në mënyrat në të cilat kanë mësuar ata në shkollë para shumë vitesh. Prandaj, është shumë me rëndësi që me prindërit të ndahen reflektime për atë se si do t'i mbështesin më së miri nxënësit dhe t'u japin rekomandime për mbështetje dhe ndjekje të nxënies (për shembull, me dhënien e informacionit përkatës kthyes).

Prindërit/kujdestarët mund të njoftohen me veglat e nxënies, me metoda të përcaktuara dhe mënyra efektive për parashtrimin e pyetjeve. Nëse ka disa fëmijë në familjen, prindërve mund t'u ndihmohet me udhëzime për nxënie të fëmijëve me moshë të përzier. Prindërve/kujdestarëve të cilët duan të mbështesin fëmijën e tyre, por nuk e dinë si, mund t'u ofrohen lista të thjeshta kontrolluese ose vegla për përvetësimin e përmbajtjeve të caktuara.

Në fillim të vitit mësimdhënësi duhet t'i mbledhë kontaktet nga prindërit (numrat e telefonit, adresat elektronike, etj.) dhe të dakordojë mënyra përkatëse të komunikimit në nivel individual dhe në nivel të grupit/klasës. Komunikimi me prindërit mund të zhvillohet në mënyra të ndryshme: në fillim përmes postës elektronike, telefonit, rrjeteve sociale, dhomave/kanaleve për bisedë, bllogjeve,



etj., ndërsa me zhvillimin e platformës kombëtare përmes kanaleve të përcaktuara për komunikim në vetë platformën. Së pari, prindërit/kujdestarët duhet të jenë të informuar për orarin dhe për kohën që nxënësi pritet ta kalojë në mësim në distancë. Më pas, duhet të njoftohen me qëllimet më të rëndësishme dhe me rezultatet e pritura nga programet mësimore. Mësimdhënësi duhet të shpërndajë informacione për materialet e nevojshme për mësim, ku mund t'i gjejnë të njëjtat dhe në çfarë kohe do të jenë të azhurnuara. Krahas materialeve të detyrueshme, mund të shpërndahen edhe materiale plotësuese që prindërit do të mund t'i përdorin në mënyrë të mëvetësishme për mbështetjen e nxënies së fëmijëve të tyre.

Përveç mësimdhënësve klasor dhe lëndor, në procesin e bashkëpunimit me prindërit duhet të përfshihet edhe shërbimi profesional i shkollës. Roli i prindërve në procesin, para së gjithash, duhet të jetë mbështetës dhe nxitës, pa kërkesa themelore në raport me shkathtësitë pedagogjike. Prindërit duhet të kujdesen që nxënësi ta ndjekë mësimin në mënyrë të vazhdueshme dhe të dinë se ku/te kush nga shkolla të drejtohen nëse përballen me vështirësi.

## **5. Mbështetje e mësimdhënësve për realizimin e mësimit në distancë**

Përballë realizimit të mësimit në klasë (duke përdorur strategji, metoda, teknika dhe mjete të ndryshme bashkëkohore për mësimdhënien, përcjelljen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve), mësimdhënësit gjatë zhvillimit të mësimit në distancë janë vënë në situatë kur duhet t'i përshtatin ato strategji ose të gjejnë strategji dhe metoda të reja për të arritur që t'i motivojnë, t'i angazhojnë dhe t'i udhëheqin nxënësit në procesin e nxënies. Për realizimin e mësimit në distancë, mësimdhënësit duhet ta thellojnë mirëkuptimin e proceseve të nxënies dhe të pasurojnë "repertorin" e tyre të metodave dhe teknikave përkatëse për "pedagogjinë e re" të arsimit në distancë, t'i zhvillojnë kompetencat e tyre për realizimin e mësimit kreativ, mbështetës dhe të përshtatur në distancë për secilin nxënësi.

Në mënyrë që të zhvillohen në „mësimdhënës të shekullit 21“ nevojitet të jenë tërësisht të mbështetur në përvetësimin e kompetencave (si pedagogjike ashtu edhe informatike). Para së gjithash, nevojitet sigurim i kushteve themelore dhe mjeteve teknike për realizimin e mësimit cilësor në distancë (kompjuter, internet-lidhje). Më pas, është i domosdoshëm trajnimi i mësimdhënësve për përdorimin e pajisjes, përdorimin e platformës kombëtare, si dhe trajnime për krijim të e-përmbajtjeve, përcjellje dhe notim në distancë, etj. Mbështetje teknike e mësimdhënësve duhet të sigurohet nga shkolla (përmes përcaktimit të personit për mbështetje teknike të mësimdhënësve), bashkësia lokale (përmes sigurimit të pajisjes, lidhjes së internetit), Ministria/Byroja për Zhvillimin e Arsimit/Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (përmes sigurimit të trajnimeve përkatëse). Mbështetja profesionale e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional duhet të jetë e siguar përmes programeve të akredituara për trajnim nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, si dhe përmes ndihmës së drejtpërdrejtë profesionale dhe këshillëdhënëse nga këshilltarët e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe nga Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim.

Mbështetja profesionale e mësimdhënësve veçanërisht duhet të jetë e orientuar drejt sigurimit të trajnimeve për:

- përdorimin e platformave,
- përpilimin e e-përmbajtjeve,
- përdorimin e e-përmbajtjeve në mësimin në shkollë,
- realizimin e mësimit në distancë,
- përcjelljen dhe notimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë.

Duhet të lokalizohen dhe të miratohen ISTE-standardet për mësimdhënësit, shkollat dhe nxënësit.

Puna e mësimdhënësit dhe realizimi i obligimeve në pikëpamje të mësimdhënies në distancë duhet të përcillen dhe të dokumentohen në mënyrë përkatëse nga drejtorja e shkollës dhe shërbimi profesional, si dhe nga BZHA-ja, ISHA-ja dhe QAPT-ja dhe të jepet mbështetje me kohë nga aspekti teknik ose pedagogjik.

## **6. Përfshirje dhe kompetenca të institucioneve arsimore në nxënien në distancë**

Realizimi i suksesshëm i nxënies në distancë është kushtëzuar edhe nga gatishmëria e institucioneve kombëtare arsimore për t'u dhënë mbështetje shkollave (drejtorëve, shërbimit profesional, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve) dhe faktorëve të tjerë në procesin arsimor (për shembull: personat juridik për realizimin e trajnimit praktik/punëdhënësit në rastin e arsimit profesional) për planifikimin, përgatitjen, organizimin, realizimin, evaluimin dhe vlerësimin e nxënies në distancë.

Në zhvillimin e zgjidhjes sistemore për nxënie në distancë, që nënkupton edhe vendosjen e platformës kombëtare për arsim fillor dhe të mesëm, do të jetë i domosdoshëm edhe planifikimi i mënyrës së përfshirjes dhe zhvillimit të veglave përkatëse, në përputhje me kompetencat në arsimin fillor dhe/ose të mesëm të institucioneve si vijon: Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Qendra për Arsimitin e të Rriturve dhe institucione të tjera që janë kompetente për arsimin fillor dhe/ose të mesëm.

Institucionet arsimore duhet që një pjesë të kompetencave të tyre, të përcaktuara me ligjet përkatëse, t'i planifikojnë dhe t'i organizojnë edhe përmes platformës së vendosur kombëtare, për shembull: ndjekje, dhënie të informacioneve kthyesë dhe udhëzimeve dhe aprovim të leksioneve të regjistruara nga mësimdhënësit, të e-përmbajtjeve, të testeve, qasje në planifikimin e mësimdhënësve, në mënyrën e realizimit të mësimit në distancë, etj. Platforma kombëtare do t'u mundësojë institucioneve shqyrtim të drejtpërdrejt në mësim, ndjekje të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional, përfshirë udhëheqje të procesit për zhvillim në karrierë të mësimdhënësve (planifikim, shqyrtim të dokumenteve, dhënie të mendimeve përkatëse dhe vendosje të rang listës së mësimdhënësve të përzgjedhur për tituj më të lartë).

Për realizimin e suksesshëm të qasjes së re të “mbështetjes këshillëdhënëse dhe profesionale në distancë”, është e domosdoshme që institucionet arsimore të marrin pajisje dhe trajnim përkatës, e para së gjithash:

- Të sigurohet e-platformë hapësinore për secilin institucion. Kjo pjesë e platformës do të shërbejë për vendosjen e përmbajtjeve digjitale, udhëzimeve, materialeve për nxënie,

simulimeve ose video-regjistrimeve të proceseve, produkteve dhe shërbimeve, katalog për zhvillim profesional të mësimdhënësve, mbështetje të shkollave (dhe kompanive) për vendosjen dhe forcimin e bashkëpunimit.

- Të sigurohet qendër multimediatike në secilin institucion. Sigurim i pajisjes përkatëse specifike për realizimin e trajnimeve të bazuara në ueb, video-konferenca, vebinarë dhe ngjashëm, si dhe përshtatjen e hapësirës përkatëse me audio-izolim, ndriçim përkatës dhe ngjashëm.
- Të forcohen institucionet me bashkëpunëtorë profesional dhe trajnim të kuadrit ekzistues për qasje, regjistrim, vendosje dhe ngjashëm në e-platformën.

Në pjesën e aktiviteteve dhe përgatitjeve të tyre për ndjekjen e mësimin në distancë, institucionet, në kuadër të kompetencave të tyre, do të duhet të përgatisin:

- Drejtime/udhëzime për mënyrën dhe formën e realizimit të e-mësimin për secilin lloj dhe nivel të arsimit (mësim klasor, mësim lëndor, arsim shkollor, arsim profesional, arsim artistik, veçanërisht drejtime dhe udhëzime për punë me nxënësit me pengesë, etj.);
- drejtime/udhëzime për të ashtuquajturën përkujdesje pastorale dhe këshillim – bashkëpunëtorët profesionalë dhe mësimdhënësit të kenë periudha të caktuara në javë për bisedë me nxënësit lidhur me gjendjen e tyre dhe sfidat me të cilat përballen.
- drejtime/udhëzime për mënyrën dhe formën e realizimit të mbështetjes këshillëdhënëse-konsultative dhe mbështetjes mentore-instruktive të mësimdhënësve (për secilin lloj dhe nivel të arsimit, mësimin teorik, ushtrime dhe trajnim praktik në arsimin profesional dhe trajnim);
- drejtime/udhëzime për ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve përmes nxënies në distancë (duke përfshirë edhe mënyrën e përpilimit të e-portofolit për nxënësit për ushtrime dhe trajnim praktik);
- drejtime/udhëzime për mënyrën dhe formën e vlerësimit të punës së mësimdhënësit për mësim në distancë.

Lidhur me sigurimin e cilësisë së materialeve dhe përmbajtjeve digjitale, nevojitet bashkëpunim mes institucioneve, si dhe bashkëpunim me ekspertë të jashtëm nga fusha e informatikës dhe nxënies në distancë në:

- përpilimin e metodologjisë për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale;
- përkufizimin e standardeve pedagogjike dhe teknike dhe rekomandimeve për përpilimin e llojeve të ndryshme të materialeve digjitale përmes të cilave sigurohet cilësi, kompatibilitet me përmbajtje të tjera dhe mundësi për përdorim të shumëfishtë;
- përkufizimin e standardeve pedagogjike dhe teknike dhe rekomandimeve për përgatitjen e proceseve të simulimit, produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmbajtjeve bashkëvepruese digjitale për realizimin e ushtrimeve laboratorike;
- përkufizim i kriterëve, përcaktim dhe zbatim i procedurave për vlerësimin e materialeve për nxënie në distancë;
- përkufizim i mënyrës së motivimit të mësimdhënësve dhe mentorëve prej kompanive për përpilimin e materialeve digjitale/përmbajtjeve/simulimeve, video-regjistrimeve dhe ngjashëm.

Në kuadër të kompetencave të tyre institucionet do të organizojnë aktivitete për promovim të nxënies në distancë dhe përgatitje të materialeve për promovim me qëllim njoftimin e përdoruesve

me mënyrën, kushtet dhe shërbimet që i ofron platforma për nxënie në distancë.

Me zhvillimin e sistemit për nxënie në distancë gradualisht do të vendoset dhe do të rregullohet me ligj mënyra e përvetësimit të certifikatave për nxënie në distancë jo vetëm për nxënësit, por edhe për mësimdhënësit, përmes zhvillimit të tyre në karrierë. Në këtë drejtim do të nevojitet:

- njohje formale/juridike e certifikatave/dokumenteve elektronike;
- sigurim të certifikimit të moduleve dhe trajnimeve që realizohen tërësisht përmes nxënies në distancë;
- rregullim i të drejtave intelektuale të materialeve/përmbajtjeve digjitale

